



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.93	2005	8 dhjetor
--------------	-------------	------------------

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9439 datë 11.11.2005	Për ratifikimine “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European për një grant deri në 16 000 000 euro”	2979
Ligj nr.9440 datë 11.11.2005	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”	2985
Ligj nr.9441 datë 11.11.2005	Për prodhimin, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi	2998

L I G J
Nr.9439, datë 11.11.2005

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR NJË GRANT DERI NË 16 000 000 EURO”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për një grant deri në 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) euro”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4704, datë 30.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

MARRËVESHJE GRANTI
NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR NJË
GRANT DERI NË 16 MILIONË EURO

1. Granti

a) Komuniteti Europian bën të vlefshme për Republikën e Shqipërisë (Vendi), sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në vendimin 2004/580/KE, në memorandumun e mirëkuptimit përkatës, një grant asistence prej dy kështesh, për shumën deri në 16 milionë euro me qëllim zbutjen e kufizimeve të financimit të huaj, duke mbështetur një situatë të qëndrueshme të bilancit të pagesave dhe duke siguruar pozicionin e rezervave të këmbimit të jashtëm. Kësti i parë do të jetë në shumën 3 milionë euro dhe kësti i dytë deri në shumën 13 milionë euro.

b) Elementi i grantit të kështit të parë dhe të dytë të asistencës është sipas termave dhe kushteve të marrëveshjes aktuale të grantit, në përputhje me memorandumun përkatës të mirëkuptimit dhe vendimin e këshillit më sipër. Disbursimet do të kushtëzohen nga ecuria e pëlqyeshme e zbatimit të programit të uljes së varfërisë ose marrëveshjeve të rëna dakord ndërmjet Vendi dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), si dhe nga vlerësimi pozitiv i Komisionit Europian në emër të Komunitetit Europian, për ecurinë e bërë lidhur me stabilitetin makroekonomik dhe reformat strukturore. Megjithatë, përpara disbursimit të kështit të dytë, Komisioni do të marrë në konsideratë mobilizimin efektiv të asistencës financiare për Vending nga donatorë të tjerë dhe nga ecuria e nevojave financiare.

c) Elementi grant do të jetë subjekt i vendimit të autoritetit buxhetor të KE-së për të bërë të vlefshme shumat e nevojshme vjetore.

2. Përdorimi i grantit

Elementi i grantit do të përdoret nga Vendi vetëm për qëllimet dhe sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen aktuale të grantit dhe në memorandumun e mirëkuptimit që i bashkëngjitet si shtojcë Marrëveshjes së grantit. Nëse fondet kanalizohen te buxheti, Ministria e Financave të Republikës së Shqipërisë dhe agjenti do t'i sigurojnë Komisionit një përgjigje zyrtare mbi këmbimin e monedhës vendase e barasvlefshme me grantin.

3. Procedura e pagesës

a) Komisioni do ta transferojë shumën e grantit në llogarinë euro të Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë pranë Bankës së Shqipërisë nr.2117311 që vepron si agjent në emër të Vendi.

b) Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje granti, pagesa e kështit të parë, e parashikuar në nenin 1 (a) dhe (b), në shumën 3 milionë euro, do të kryhet nga Komisioni brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve nga miratimi i ecurisë së kushteve siç përcaktohet në nenin 1 (b) dhe do të gjykohet si e bërë në datën në të cilën debitohet për llogari të Komisionit.

c) Pagesa e kështit të dytë, e parashikuar në nenin 1 (a) dhe (b) në shumën deri në 13 milionë euro, do të bëhet nga Komisioni brenda 45 (dyzet e pesë) ditësh nga miratimi i ecurisë së kushteve siç përcaktohet në nenin 1 (b) dhe do të gjykohet e bërë në datën në të cilën debitohet për llogari të Komisionit.

d) Me mbarimin e periudhës së pagesës të specifikuar në paragrafët (b) dhe (c), Vendi, brenda dy muajve pas datës së marrjes së pagesës së fundit, mund të kërkojë pagesën e interesit mbi pagesën e fundit me normën e interesit e zbatueshme nga Banka Qendrore Europiane për veprimtaritë e financuara në euro, plus tri pikë e gjysmë; norma reference mbi bazën e së cilës aplikohet rritja do të jetë norma në fuqi e ditës së parë të muajit të ditës përfundimtare të pagesës, siç publikohet në seritë C të Fletores Zyrtare të Komunitetit Europian.

Interesi mbi pagesën e fundit do të mbulojë përjashtuar periudhën nga data përfundimtare e pagesës, përfshirë deri në ditën e pagesës siç përcaktohet në nënparagrafin paraardhës. Pezullimi i pagesës nga Komisioni mund të mos konsiderohet si pagesë e fundit.

e) Vendi merr përsipër të paguajë të gjitha kostot dhe shpenzimet e lindura lidhur me transaksionet financiare të grantit.

f) Vendi deklaron se të gjitha pagesat dhe transfertat sipas kësaj Marrëveshjeje granti, si dhe vetë Marrëveshja e grantit, nuk do të jetë subjekt i taksave ose ndonjë tjetër tatim në Vend dhe nuk do të jetë subjekt për të gjithë periudhën e kësaj Marrëveshjeje granti.

4. Kontrolli, parandalimi i abuzimeve dhe auditimet

a) Komisioni, përfshirë Zyrën Europiane Kundër Abuzimeve dhe Gjykatën Europiane të Auditorëve do të kenë të drejtën të dërgojnë agjentët e tyre ose përfaqësuesit e duhur të autorizuar për të kryer kontrole apo auditime teknike ose financiare që ata i konsiderojnë të nevojshme lidhur me menaxhimin e kësaj asistence gjatë gjithë periudhës së memorandumit të mirëkuptimit dhe për pesë vjet pas disbursimit të kështit të fundit të grantit.

b) Vendi dhe agjenti do të sigurojnë të gjithë informacionin dhe dokumentet që do të kërkohen për qëllimin e vlerësimeve të tilla, dhe të marrë të gjitha masat e përshtatshme për të lehtësuar punën e personave të udhëzuar për t'i kryer ato. Vendi dhe agjenti marrin përsipër t'u japin personave të referuar në paragrafin (a) aksesin në vendet ku mbahen dokumentet dhe informacioni përkatës.

c) Vendi dhe agjenti do të sigurojnë shqyrtimin dhe trajtim të pëlqyeshëm të rasteve aktuale dyshuese për abuzim, korrupsion ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal lidhur me menaxhimin e asistencës financiare makro të Komunitetit që dëmton interesat financiare të Komunitetit. Të gjitha rastet e tilla, si dhe masat përkatëse të ndërmarra nga autoritetet kombëtare kompetente do t'i raportohen Komisionit pa vonesë.

5. Përfundimi dhe ripërtëritja

Në rastin kur është vendosur se lidhur me këtë asistencë, Vendi ose agjenti është përfshirë në ndonjë akt abuzimi ose korrupsioni ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal dëmtues ndaj interesave financiare të Komunitetit, Komisioni është i autorizuar ta përfundojë këtë marrëveshje dhe/ose të procedojë për ripërtëritjen e plotë ose të pjesshme të grantit nga Vendi në proporcion me peshën e dëmtimeve, dhe pas lejimit të vendit për të mbikëqyrur dhe sipas çfarëdo termave dhe në çfarëdo datë që Komisioni mund ta specifikojë. Shuma për t'u shlyer do të përmbajë principalin dhe interesin e fituar të llogaritur duke përdorur normën e aplikueshme nga Banka Qendrore Europiane për veprimtaritë kryesore rifinancuese, siç publikohet në seritë C të Fletores Zyrtare të Komunitetit Europian (norma e rifinancimit ECB) në fuqi në ditën e parë kalendarike të muajit në të cilin granti u pagua nga Komisioni.

Interesvonesa për shumat e marra, të pashlyera në datën e duhur, do të jetë norma e rifinancimit ECB, në fuqi në datën e parë kalendarike të muajit në të cilin përkojnë datat e duhura, të rritura me tri pikë e gjysmë përqindjeje. Të gjitha pagesat do të jenë në euro.

6. Ligji i zbatueshëm dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve

a) Kjo asistencë makrofinanciare do të qeveriset nga kushtet e marrëveshjes së grantit, nga rregullat e zbatueshme të Komunitetit dhe si bazë dytësore nga legjislacioni belg, i zbatueshëm për këtë lloj kategori veprimesh.

b) Palët do të bëjnë çdo gjë të mundshme për të zgjidhur miqësisht çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet tyre gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje granti. Ato do të komunikojnë pozicionet e tyre dhe ndonjë zgjidhje që ata e konsiderojnë të mundshme me shkrim, dhe të takojnë njëri-tjetrin me kërkesën e secilit. Njëra palë duhet t'i përgjigjet kërkesës për zgjidhjen miqësore brenda 30 ditëve. Me skadimin e kësaj periudhe ose nëse përpjekja për zgjidhjen miqësore nuk rezulton në marrëveshje, brenda 120 ditëve nga kërkesa e parë, secila palë duhet ta njoftojë tjetrën se konsideron procedurën të dështuar.

c) Në rast dështimi për të arritur në një marrëveshje miqësore, mosmarrëveshja duhet të sillet para Gjykatës së Shkallës së Parë të Komunitetit European dhe, në rast apelimi, përpara Gjykatës së Drejtësisë të Komunitetit European.

7. Data e skadencës

Kjo Marrëveshje është e vlefshme deri më 6 gusht 2006, e cila është data e fundit për pagesë në përputhje me përmbushjen e kushteve të specifikuara në anekset I dhe II të memorandumit të mirëkuptimit.

Bërë në Bruksel më2005 dhe në Tiranë më2005 në katër kopje origjinale në gjuhën angleze.

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

1. Në 29 prill 2004, Këshilli i Komunitetit European miratoi një vendim për të bërë të vlefshme për Republikën e Shqipërisë (që tani e tutje referohet si "Vendi") një asistencë makro-financiare deri në 25 milionë euro, e përbërë nga një lehtësirë huaje deri në 9 milionë euro (huaja) dhe një lehtësirë granti deri në 16 milionë euro (granti) (Vendimi 2004/580/KE). Objektivi i kësaj asistence është të zbusë vështirësitë e financimeve të huaja të Vendit, të mbështesë bilancin e pagesave dhe të fuqizojë pozicionin e rezervave të këmbimit të huaj. Asistenca nga Komuniteti European është plotësues i burimeve të siguruara për Vendin nga institucionet financiare ndërkombëtare dhe donatorët bilateralë në mbështetje të stabilizimit ekonomik të autoriteteve dhe programit të reformave.

2. Asistenca do të disbursohet në të paktën dy këste. Disbursimi i asistencës do të kushtëzohet nga ecuria e pëlqyeshme në zbatimin e marrëveshjes aktuale ose marrëveshjeve pasuese të rëna dakord ndërmjet Vendit dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), si dhe nga vlerësimi pozitiv nga Komisioni European (që tani e tutje i referohet si "Komisioni") në emër të Komunitetit European nga ecuria e bërë në lidhje me stabilizimin ekonomik dhe reformat strukturore.

Kushtet makroekonomike dhe politika e rregullimeve strukturore të bashkëngjitura kësaj asistence bazohen në stabilizimin ekonomik dhe programin e reformave të nënshkruara nga autoritetet e vendit dhe që janë në përputhje me marrëveshjet e arritura nga Vendi me FMN.

Kriteret sasiore të performancës bashkëngjitur asistencës së Komunitetit do të jenë ato të specifikuara me Marrëveshjen aktuale për uljen e varfërisë dhe rritjen ekonomike ose marrëveshje pasuese të rëna dakord ndërmjet Vendit dhe FMN-së. Përpara disbursimit të çdo kësti të kësaj asistence, Komisioni, në bashkëpunim me autoritetet kombëtare dhe stafin e FMN-së, do të verifikojnë se kriteret sasiore të performancës janë respektuar siç duhet, ose është rënë dakord për kuptime të reja. Kriteret aktuale sasiore përmbajnë:

- i) Kufij tremujorë për aktivet neto të brendshme të Bankës së Shqipërisë (BSH);
- ii) Kufij tremujorë për kredinë neto të sistemit bankar për qeverinë qendrore të konsoliduar;
- iii) Objektiva treguese tremujore të të ardhurave totale nga taksat;
- iv) Tavane tremujore për rezervat neto ndërkombëtare të BSH-së;
- v) Kufij tremujorë për kontraktimin ose garantimin e borxhit të jashtëm publik jo-koncesional dhe publik i garantuar.

3. Për shumat e sakta dhe kohën e disbursimit të secilës transhe do të bihet dakord nga të dyja palët në kuadër të grantit dhe/ose marrëveshjeve të huasë. Disbursimi i dytë dhe këstet e mëpasme nuk do të bëhen përpara të paktën tre muaj pas disbursimit të këstit të mëparshëm.

Në përcaktimin e shumave që do të disbursohen nga kjo asistencë, do të merret në konsideratë mobilizimi i efektshëm i asistencës financiare ndaj vendit nga donatorë të tjerë dhe ecuria e nevojave financiare.

Pas marrjes së njoftimeve të përputhshmërisë nga autoritetet e vendit dhe përpara pagesës së çdo kësti, Komisioni do të vlerësojë, në bashkëpunim me autoritetet e vendit, ecurinë e bërë lidhur me përmbushjen e kriterëve sasiore të performancës dhe një numër të përzgjedhur të kriterëve të reformave strukturore. Në këtë vlerësim, vëmendje e veçantë do t'i jepet reformës së financave publike dhe administrimit, reformave në sektorin bankar dhe zhvillimin e sektorit privat.

Kuadri referues për këtë vlerësim jepet shprehimisht në shtojcën I. Mund të rregullohet në një fazë të mëvonshme.

4. Pagesa e efektshme e kësteve të ndryshme do të jetë subjekt i nënshkrimit të angazhimeve ligjore përkatëse (marrëveshje granti/huaje) nga palët. Këstet e grantit do të jenë subjekt i vendimit të autoritetit buxhetor të KE-së për t'i bërë të vlefshme shumat e nevojshme.

5. Komisioni do t'i bëjë të vlefshme shumat e huasë dhe grantit të Banka e Shqipërisë (BSH) që vepron si agjent i Vendit ose tek institucioni ose institucionet e caktuara për të marrë përgjegjësitë nga BSH për marrjen e fondeve në kontekstin e kësaj asistence makrofinanciare komunitare.

Autoritetet e vendit marrin përsipër të përmbushin në kohën e duhur dhe plotësisht të gjitha detyrimet financiare që burojnë nga huatë e siguruar ose të garantuara nga Komuniteti Europian.

Gjatë zbatimit të asistencës, autoritetet e Vendit do t'i sigurojnë Komisionit të gjithë informacionin përkatës lidhur me monitorimin e situatës financiare dhe ekonomike dhe që do të jetë e nevojshme për vlerësimin e kriterëve sasiore të performancës dhe për rishikimin e ecurisë së reformave strukturore. Në veçanti, autoritetet do t'i japin Komisionit mbi baza tremujore informacionin përkatës siç përcaktohet në shtojcën II.

6. Komisioni, i përfaqësuar nga agjentët e tij ose ekspertët e duhur të mandatuar, do të ketë të drejtën të kryejë vlerësimet operative të procedurave administrative dhe të rrjetit financiar të Vendit dhe të agjentit lidhur me menaxhimin e asistencës makrofinanciare komunitare.

7. Një vlerësim i pavarur ex-post i asistencës mund të kryhet nga Komisioni ose përfaqësuesit e duhur të autorizuar. Autoritetet e vendit janë të angazhuara të japin të gjithë informacionin e nevojshëm sipas rastit. Raporti i vlerësimit do të bëhet i vlefshëm për ta për komente.

8. Autoritetet do të sigurojnë, në mënyrë të duhur, bashkëpunim të ngushtë me Komisionin Europian.

9. Asistenca zbatohet me kuptimin që autoritetet e Vendit do të vazhdojnë të respektojnë rregullën e ligjit, demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

10. Sipas vendimit të Këshillit të KE-së/2004/580 të 29 prillit 2004, kjo asistencë do të zbatohet deri më 6 gusht 2006.

11. Shtojcat I dhe II janë pjesë përbërëse e këtij memorandumi.

13. Të gjitha njoftimet, lidhur me memorandumin aktual, do të jepen me shkrim dhe do të dërgohen tek:

Për Komunitetin Europian

Komisioni i Komunitetit Europian
Drejtoria e Përgjithshme për Çështjet Financiare dhe
Ekonomike

Rue de la Loi, 200-BU-1 1/57, B-1049 Bruksel
Nr.faksit (+32-2) 299 61 51

Për Vendin

Ministri i Financave
Arben Malaj
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit"
Tiranë, Shqipëri
Nr.faksit: +355 422 8494

Për Bankën Kombëtare të Vendit

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë
Sheshi "Skënderbej" nr.1
Nr.faksit + 355 422 3558

Bërë në Bruksel në gjuhën angleze2005 dhe në Tiranë në2005 në katër kopje origjinale.

Republika e Shqipërisë
Përfaqësuar nga
Ministri i Financave
Arben Malaj

Komiteti Europian
Përfaqësuar nga
Komisioni Europian
Joaquin Almunia
Anëtar i Komisionit

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë
Ardian Fullani
Guvernator

SHTOJCA I KRITERET E REFORMAVE STRUKTURE

1. Veprimet për t'u ndërmarrë nga Ministria e Financave përpara disbursimit të kështit të parë për të thelluar sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit financiar dhe kontrolleve administrative.

- Për thesarin, qartësimi dhe formalizmi i delegimit të autoritetit nga niveli (niveli i cili mund të kërkojë, miratojë, urdhërojë, marrë, paguajë, rakordojë, për cilat lloj shpenzimesh, deri në cilën shumë) dhe të sigurojë ndarjen e duhur të detyrave. Stafi i cili kryhen pagesat, nuk do të ketë detyrë për të miratuar pagesat ose rakorduar shumat.

- Të zbatojë firmosjen e dyfishtë të pagesave nga thesari.

2. Në kohën kur Komisioni rishikon se do t'i paraprijë vendimit lidhur me disbursimin e kështit të dytë, autoritetet janë të angazhuara të kenë arritur ecuri në fushat e mëposhtme:

Masat për të thelluar sigurinë dhe besueshmërinë e rrjetit financiar dhe kontrolleve administrative dhe për të përmirësuar menaxhimin e financave publike.

- Dërgim tremujor nga Ministria e Financave të Këshilli i Ministrave të Raporteve të Auditit të Brendshëm të ministrave të linjës, së bashku me rekomandimet për rregullimin e veprimeve në fushat e identifikuara.

- Miratimi i Letër Politikës për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike.

- Ecuri në futjen e sistemit të ri të integruar të IT për të mbështetur aktivitetet bazë të thesarit.

Në veçanti, fillimi i operacionit të trefishtë në distriktin e Tiranës.

Masat për të përmirësuar funksionimin e administratës publike dhe luftës kundër korrupsionit.

- Procedimi i pagesës në të paktën 50% të pagave të sektorit publik nëpërmjet sistemit bankar.

- Miratimi (*) i kuadrit ligjor mbi konfliktin e interesave.

- Miratimi i masave ligjore për të kufizuar vonesat në procesin gjyqësor.

Reforma e sektorit financiar

-Miratimi i ligjit të ri për sektorin bankar.

-Futja te Banka e Shqipërisë e një sistemi software të integruar dhe zbatimi gjatë gjithë vitit 2005 i planit të mbikëqyrjes bankare.

-Miratimi i akteve nënligjore për sigurimet/risigurimet, përfshirë rregulla të kujdesshme lidhur me risigurimin.

*"Miratimi" duhet të kuptohet në shtojcën aktuale si "Miratim qeveritar"

Masat për të përmirësuar mjedisin e biznesit dhe për të përsheptuar zhvillimin e sektorit privat.

- Miratimi i planit të ri të veprimeve mbi heqjen e barrierave administrative.

- Miratimi i ligjit të ri mbi regjistrimin tregtar me qëllimin e lehtësimit të futjes në treg.

- Ofrimi për shitje (tenderi përfundimtar) i Albtelekomit dhe ARMO-s.

SHTOJCA II SISTEMI I MONITORIMIT

Gjatë zbatimit të asistencës komunitare, treguesit në vijim dhe raportet do të bëhen të vlefshme për Komisionin nga autoritetet përkatëse mbi baza tremujore.

1. Monitorimi i zhvillimeve makroekonomike, financiare dhe politikave:

- PBB ose të ardhurat kombëtare (të dhëna vjetore ose tremujore kur të jenë të vlefshme)

komponentët kryesorë të PPB (të dhëna vjetore);

- Prodhimi industrial (mujo);
 - Pagat (mujo);
 - Përqindja e punësimit dhe papunësisë (mujo);
 - Treguesit e çmimeve (mujo);
 - Normat e interesave afatshkurtra (mujo);
 - Niveli dhe përbërja e të ardhurave qeveritare dhe shpenzimeve, si dhe detyrimeve të prapambetura qeveritare (niveli i qeverisjes qendrore, mujo);
 - Tregtia e jashtme (mujo);
 - Bilanci i pagesave (tremujo);
 - Pozicioni i rezervave ndërkombëtare (mujo);
 - Kurset e këmbimit valutor (javore);
 - Borxhi i jashtëm (tremujo) përfshirë detyrimet e prapambetura të jashtme (tremujo);
 - Pagesat e shërbimit të borxhit (tremujo);
2. Monitorimi i politikave strukturore;
- Raport progresi i reformës së financave publike dhe administrative;
 - Raport progresi i reformës në sistemin bankar;
 - Raport progresi i zhvillimit të sektorit privat.

L I G J

Nr.9440, datë 11.11.2005

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT PËR SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, NË LIDHJE ME TATIMET MBI TË ARDHURAT DHE MBI KAPITALIN”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin”, bërë në Kajro më 23 shkurt 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4705, datë 30.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë
Alfred Moisiu

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT PËR SHMANGIEN E TATIMEVE TË DYFISHTA DHE
PËR PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL LIDHUR ME TATIMET MBI TË ARDHURAT

DHE MBI KAPITALIN

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Arabe të Egjiptit, duke dëshiruar të përfundojnë një marrëveshje për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe për parandalimin e evazionit fiskal, lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, kanë rënë dakord për sa vijon:

Neni 1

Subjektet mbi të cilat zbatohet marrëveshja

Kjo Marrëveshje do të zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose të të dy Shteteve Kontraktuese.

Neni 2

Tatimet që mbulon marrëveshja

1. Kjo Marrëveshje do të zbatohet për tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin, që vendosen në emër të një shteti kontraktues ose nënndarjeve të tij politike ose autoriteteve lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin të gjitha tatimet e vendosura mbi të ardhurat në total, mbi kapitalin në total, ose mbi elemente të të ardhurave ose të kapitalit, përfshirë tatimet mbi fitimet nga shitblerja e pasurive të luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumatat totale të pagave dhe rrogave, si edhe tatimet mbi rivlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese, ndaj të cilave do të zbatohet Marrëveshja, janë:

a) Në rastin e Republikës së Shqipërisë:

i) tatimi mbi fitimin;

ii) tatimi mbi biznesin e vogël;

iii) tatimi mbi të ardhurat personale;

iv) tatimi mbi pasurinë;

(në vijim do t'i referohemi si "tatimi shqiptar").

b) Në rastin e Republikës Arabe të Egjiptit:

i) tatimi mbi të ardhurat e realizuara nga pasuritë e paluajtshme (përfshirë tatimin mbi tokën dhe tatimin mbi ndërtesat);

ii) tatimi i unifikuar mbi të ardhurat e individëve;

iii) tatimi mbi fitimet e korporatave;

iv) tatimi për zhvillimin i zbatuar nga ligji nr.147 i vitit 1984 dhe amendamentet e tij;

v) tatimet suplementare të zbatuara në përqindje mbi tatimet e përmendura më sipër apo në forma të tjera;

(në vijim do t'i referohemi si "tatimi egjiptian").

4. Marrëveshja do të zbatohet gjithashtu për tatime të njëllota ose esencialisht të ngjashme, të cilat do të vendosen pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, si shtojcë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të njoftojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre tatimore.

Neni 3

Përcaktime të përgjithshme

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe:

a) termi "Shqipëria" nënkupton Republikën e Shqipërisë, dhe i përdorur në sensin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si edhe çdo zonë tej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe me ligjet e Republikës së Shqipërisë, është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejta, lidhur me tabanin detar, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) termi "Egjipt" nënkupton Republikën Arabe të Egjiptit, dhe kur përdoret në kuptimin

gjeografik, termi “Egjpt” përfshin:

i) ujërat territoriale atje, dhe
ii) tabanin detar dhe nëntokën e zonave detare pranë bregut, por përtej ujërave territoriale, mbi të cilat Egjipti ushtron të drejtat sovrane, në përputhje me legjislacionin egjiptian dhe të drejtën ndërkombëtare për qëllim të zbulimit dhe shfrytëzimit të burimeve natyrore të asaj zone, por vetëm me kufizimin që personi, pasuria apo aktiviteti ndaj të cilëve zbatohet Marrëveshja është i lidhur me një zbulim apo shfrytëzim të tillë;

c) termat “një Shtet Kontraktues” dhe “Shteti tjetër Kontraktues” nënkuptojnë Egjiptin ose Shqipërinë siç e kërkon përmbajtja;

d) termi “person” përfshin një individ, një shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

c) termi “kompani” (shoqëri) nënkupton çdo trup korporativ ose çdo ent që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) termat “sipërmarrje e një Shteti Kontraktues” dhe “sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues” nënkuptojnë respektivisht një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe një sipërmarrje të ushtruar nga një rezident i Shtetit tjetër Kontraktues;

g) termi “tatim” nënkupton tatimin shqiptar ose tatimin egjiptian, siç e kërkon përmbajtja;

h) termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije apo avion apo mjet të transportit rrugor që operohet nga një sipërmarrje që ka vendin e drejtimit efektiv në një Shtet Kontraktues, përveç kur anija, avioni ose mjeti i transportit rrugor, vepron vetëm midis vendeve të ndodhura në territorin e Shtetit tjetër Kontraktues;

i) termi “autoritet kompetent” nënkupton:

a) në rastin e Shqipërisë, Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij;

b) në rastin e Egjiptit, Ministrin e Financave ose përfaqësuesin e autorizuar prej tij;

j) termi “nënshtetas” nënkupton:

a) çdo individ që zotëron nënshtetësinë e një Shteti Kontraktues;

b) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që gëzon statusin si e tillë nga ligjet në fuqi në një Shtet Kontraktues.

2. Përsa i përket zbatimit të Marrëveshjes nga një Shtet Kontraktues, çdo term i papërcaktuar këtu, përderisa përmbajtja të mos e kërkojë ndryshe, do të ketë kuptimin që i është dhënë sipas legjislacionit të atij shteti, lidhur me tatimet e të cilit zbatohet Marrëveshja. Çdo kuptim në bazë të ligjeve tatimore të atij shteti ka përparësi ndaj kuptimeve të tjera që mund t’i jepen termit nga ligje të tjera të atij shteti.

Neni 4

Rezidenti

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i një Shteti Kontraktues” nënkupton çdo person që, sipas ligjeve të atij shteti, është subjekt i tatimeve atje për shkak të vendbanimit, rezidencës, vendit të drejtimit apo çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë statusi i tij do të përcaktohet si vijon:

a) ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij; në qoftë se ai ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në të dy shtetet, ai do të konsiderohet rezident i shtetit me të cilin interesat e tij personale dhe ekonomike janë të lidhura më ngushtë (qendra e interesave jetikë);

b) në qoftë se shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave jetikë nuk mund të përcaktohet, ose në qoftë se ai nuk ka një banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjërin shtet, ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin ai qëndron zakonisht;

c) në qoftë se ai qëndron rregullisht në të dy shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin ai është nënshtetas;

d) në qoftë se ai është nënshtetas i të dy shteteve ose i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do ta zgjidhin këtë çështje me mirëkuptim reciprok.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person jo individ është rezident i të dy Shteteve Kontraktuese, atëherë ai do të konsiderohet rezident i shtetit në të cilin është vendosur vendi i drejtimit efektiv të tij.

Neni 5

Seli e përhershme

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend fiks biznesi nëpërmjet të cilit ushtrohet tërësisht ose pjesërisht biznesi i një sipërmarrjeje.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

- a) një vend drejtimi,
- b) një degë,
- c) një zyrë;
- d) një fabrikë;
- e) një punishte;

f) një minierë, një pus nafte ose gazi ose çdo vend tjetër për shfrytëzimin e burimeve natyrore;

f) një fermë apo plantacion;

h) ambiente apo magazina të përdorura si vende për shitje.

3. Termi “seli e përhershme” gjithashtu përfshin:

a) një shesh ndërtimi, një konstruksion, një projekt montimi ose instalimi apo aktivitete mbikëqyrjeje të lidhura me to, por vetëm kur sheshe, projekte apo aktivitete të tilla vazhdojnë për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë gjashtë muaj, brenda çdo periudhe 12-mujore.

b) furnizimin e shërbimeve, përfshirë shërbimet e konsultimit, nga një sipërmarrje nëpërmjet të punësuarve apo personeli tjetër, por vetëm kur aktivitete të kësaj natyre (për të njëjtin projekt ose projekte të lidhura me të) vazhdojnë brenda vendit për një periudhë ose periudha që në total i kalojnë gjashtë muaj brenda çdo periudhe 12-mujore.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” nuk do të përfshijë:

a) përdorimin e pajisjeve apo objekteve vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi të mallrave që i përkasin sipërmarrjes;

b) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi ose ekspozimi;

c) mbajtjen e një gjendje mallrash që i përkasin sipërmarrjes vetëm për qëllime përpunimi nga një sipërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim blerjen e mallrave ose për mbledhje informacioni për sipërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për qëllim të ushtrimit, për sipërmarrjen, të çdo aktiviteti tjetër me karakter përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi fiks biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët (a) deri (e) me kusht që aktiviteti në kompleks i këtij vendi fiks biznesi që rezulton nga ky kombinim të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 7, vepron në një Shtet Kontraktues në emër të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, kjo sipërmarrje do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin Kontraktues të përmendur në fillim lidhur me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për sipërmarrjen, në qoftë se personi ka dhe zakonisht e ushtron në shtetin e përmendur në fillim, një autoritet për të përfunduar kontrata në emër të sipërmarrjes, përveç kur aktivitetet e këtij personi kufizohen në ato të përmendura në paragrafin 4, të cilat, edhe pse ushtrohen nëpërmjet një vendi fiks biznesi, nuk e bëjnë këtë vend fiks biznesi një seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Pavarësisht nga dispozitat e mëparshme të këtij neni, një sipërmarrje sigurimi e një Shteti Kontraktues, përjashtuar risigurimet, do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues, nëse ajo mbledh prime sigurimi në territorin e atij shteti tjetër ose siguron atje rrezeqe nëpërmjet një personi të ndryshëm nga një agjent me status të pavarur ndaj të cilit zbatohet paragrafi 7.

7. Një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues nuk do të konsiderohet se ka një seli të përhershme në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm për faktin se ajo ushtron biznesin në këtë shtet tjetër nëpërmjet një ndërmjetësi, komisioneri të përgjithshëm apo çdo lloj agjenti tjetër me një status të pavarur, me kusht që të tillë persona veprojnë brenda kuadrit të zakonshëm të aktivitetit të tyre. Megjithatë, kur

aktivitetet e një ndërmjetësi të tillë kryhen tërësisht ose thuajse tërësisht në emër të asaj sipërmarrjeje, ai (ndërmjetësi) nuk do të konsiderohet një agjent me një status të pavarur në kuptimin e këtij paragrafi.

8. Fakti që një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues kontrollon ose kontrollohet nga një kompani që është rezidente e Shtetit tjetër Kontraktues, ose që ushtron aktivitet në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose në formë të tjera), nuk përbën në vetvete arsye të mjaftueshme për ta konsideruar njërën kompani seli të përhershme të tjetrës.

Neni 6

Të ardhurat nga pasuria e paluajtshme

1. Të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga pasuria e paluajtshme (përfshirë të ardhurat nga bujqësia dhe pyjet) të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” do të ketë kuptimin që ka sipas ligjit të Shtetit Kontraktues ku është vendosur prona në fjalë. Në çdo rast ky term do të përfshijë pasuritë aksesore të pasurisë së paluajtshme, inventarin e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi e në pyje, të drejtat ndaj të cilave zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm lidhur me pronën mbi tokën, uzufrukti i pasurive të paluajtshme dhe të drejtat ndaj pagesave fikse ose të ndryshueshme për shfrytëzimin ose të drejtën për të shfrytëzuar vendburimet minerare dhe burime e pasuri të tjera natyrore. Anijet, varkat dhe avionët nuk konsiderohen pasuri e paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 do të zbatohet edhe ndaj të ardhurave të realizuara nga përdorimi direkt, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurive të paluajtshme.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 do të zbatohen gjithashtu ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e një sipërmarrjeje dhe ndaj të ardhurave nga pasuria e paluajtshme e përdorur për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura.

Neni 7

Fitimet nga biznesi

1. Fitimet e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në atë shtet, përveç kur sipërmarrja ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty. Në qoftë se sipërmarrja ushtron aktivitetin në mënyrën e sipërpërmendur, fitimet e sipërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm ajo pjesë e tyre që i atribuohet asaj selie të përhershme.

2. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni, kur një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, atëherë në secilin Shtet Kontraktues selisë së përhershme do t’i atribuohen fitimet që ajo do të realizonte sikur të ishte një sipërmarrje e veçantë dhe e pavarur, që do të vepronte në të njëjtin aktivitet ose në aktivitete të ngjashme, nën kondita të njëjta ose të ngjashme, tërësisht e pavarur nga sipërmarrja, seli e përhershme e së cilës ajo është.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohet zbritja e shpenzimeve që janë kryer për qëllimet e biznesit të selisë së përhershme, përfshirë shpenzimet e përgjithshme administrative dhe ekzekutive të kryera si në shtetin ku ndodhet selia e përhershme, ashtu edhe diku tjetër.

4. Asnjë fitim nuk mund t’i atribuohet një selie të përhershme vetëm për faktin se kjo seli e përhershme blen mallra për sipërmarrjen.

5. Përderisa për përcaktimin e fitimeve që do t’i atribuohen një selie të përhershme në një Shtet Kontraktues është përdorur metoda e ndarjes së fitimeve totale të sipërmarrjes në pjesët e saj të ndryshme, dispozitat e paragrafit 2 nuk e pengojnë atë Shtet Kontraktues për përcaktimin e fitimeve që do të tatohen me një metodë të tillë, siç mund të jetë vepruar zakonisht, megjithatë, metoda e ndarjes e adoptuar duhet të jetë e tillë që rezultati të përputhet me parimet që përmban ky nen.

6. Për qëllimet e paragrafëve të mësipërm, fitimet që do t’i atribuohen selisë së përhershme do të përcaktohen me të njëjtën metodë vit pas viti, përderisa të mos ketë arsye të forta për të vepruar ndryshe,

7. Kur fitimet përmbajnë elemente të të ardhurave që trajtohen veças në nene të tjera të kësaj

Marrëveshjeje, atëherë dispozitat e tyre neneve nuk do të ndikohen nga dispozitat e këtij neni.

Neni 8

Transporti ajror dhe detar

1. Fitimet nga veprimtaria e anijeve apo avionëve në trafikun ndërkombëtar do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues ku ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

2. Nëse vendi i drejtimit efektiv i një sipërmarrjeje detare ndodhet në bordin e një anijeje, atëherë ajo do të konsiderohet e vendosur në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet porti i qëndrimit të zakonshëm të anijes ose, nëse nuk ka një port të tillë, në Shtetin Kontraktues, rezidenti i të cilit është operuesi i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni do të zbatohen gjithashtu ndaj fitimeve të realizuara nga pjesëmarrja në një bashkësi, një biznes të përbashkët apo një agjenci ndërkombëtare transporti.

Neni 9

Sipërmarrje të lidhura

1. Kur:

a) një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues merr pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë direkt ose indirekt në drejtimin, kontrollin apo kapitalin e një sipërmarrjeje të një Shteti Kontraktues dhe të një sipërmarrjeje të Shtetit tjetër Kontraktues, dhe në secilin rast kushtet që janë pranuar ose që janë diktuar midis dy sipërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare apo financiare ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim që do të realizohej nga njëra sipërmarrje, por që për shkak të lidhjeve të veçanta të përmendura në fillim nuk është realizuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj sipërmarrjeje dhe të tatohet normalisht.

2. Kur një Shtet Kontraktues përfshin në fitimet e një sipërmarrjeje të atij shteti, dhe i tatton ato normalisht, fitime për të cilat një sipërmarrje e Shtetit tjetër Kontraktues është rënduar me tatim në atë shtet tjetër dhe fitimet e përfshira në këtë mënyrë janë fitime që do të ishin realizuar nga sipërmarrja e shtetit të përmendur në fillim, nëse konditat e krijuara midis dy sipërmarrjeve kanë qenë ato që do të vendoseshin midis sipërmarrjeve të pavarura, atëherë ai shtet tjetër do të bëjë një rregullim në masën e duhur të shumës së tatimit të vendosur në atë shtet mbi këto fitime. Në përcaktimin e rregullimeve të tilla duhet t'i kushtohet vëmendje edhe dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

3. Një Shtet Kontraktues nuk do t'i ndryshojë fitimet e një sipërmarrjeje në rrethanat e referuara në paragrafin 1 pas kalimit të afateve kohore të përcaktuara në legjislacionin e tij të brendshëm dhe, në asnjë rast, pas kalimit të një periudhe pesëvjeçare nga përfundimi i vitit në të cilin do të realizoheshin nga një sipërmarrje e atij shteti fitimet që duhej t'i nënshtroheshin një ndryshimi të tillë.

4. Dispozitat e paragrafëve 2 dhe 3 nuk do të zbatohen në raste mashtrimesh, fshehje të paramenduara apo angazhimi.

Neni 10

Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, të tillë dividendë mund të tatohen gjithashtu në Shtetin Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i dividendëve, tatimi i ngarkuar nuk do të kalojë 10 për qind të shumës bruto të dividendëve. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të zgjidhin me mirëkuptim reciprok mënyrën e aplikimit të këtij kufizimi. Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të kenë efekt mbi tatimin e kompanisë lidhur me fitimet nga të cilat janë paguar dividendët.

3. Në funksion të këtij neni, termi “dividendë” nënkupton të ardhurat nga aksionet e çdo lloji ose të drejta të tjera, që nuk janë kërkesa borxhi, pjesëmarrja në fitime, si edhe të ardhurat nga të drejta

të tjera korporative që i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit, rezidente e të cilit është kompania që bën shpërndarjen e dividendëve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron aktivitet në Shtetin tjetër Kontraktues, rezidente e të cilit është kompania paguese e dividendëve, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Kur një kompani që është rezidente e një Shteti Kontraktues realizon fitime ose të ardhura nga Shteti tjetër Kontraktues, ky shtet tjetër mund të mos zbatojë tatim mbi dividendët e paguar nga kompania, përveç kur këto dividendë i paguhen një rezidenti të shtetit tjetër ose kur zotërimi, lidhur me të cilin janë paguar dividendët, është efektivisht i lidhur me një seli të përhershme ose një bazë fikse të vendosur në këtë shtet tjetër. Subjekt i tatimit mbi fitimet e pashpërndara nuk janë gjithashtu as fitimet e pashpërndara të kompanisë, edhe sikur dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara konsistojnë tërësisht ose pjesërisht si fitime apo të ardhura të realizuara në këtë shtet tjetër.

Neni 11

Interesat

1. Interesat që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto interesa mund të taten edhe në Shtetin Kontraktues ku ato krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por kur marrësi është pronari përfitues i interesave, tatimi i zbatuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të interesit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi,

3. Termi “interesa” në kuptimin e përdorur në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga kërkesat e borxhit të çdo lloji, të siguruara ose jo me hipotekim ndaj pasurive, dhe që e kanë ose jo të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet debitorit, dhe në veçanti të ardhurat nga bonot e thesarit dhe obligacionet, përfshirë çmimet dhe shpërblimet që u shtohen këtyre bonove dhe obligacioneve.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni nuk do të zbatohen në qoftë se pronari përfitues i interesave, duke qenë një rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues ku krijohen interesat, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse të vendosur aty, dhe kërkesa e huasë, lidhur me të cilën paguhet interesi, është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Interesat do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues, kur paguesi është vetë ai shtet, një autoritet lokal ose një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që pagan interesat, qoftë ose jo rezident i njërit Shtet Kontraktues, ka në njërin Shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur huaja për të cilën paguhet interesi, dhe këto interesa krijohen nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto interesa do të konsiderohen se janë krijuar në shtetin ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur, për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues të interesave ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e interesave, bazuar në huanë për të cilën ato paguhen, e kalon shumën mbi të cilën duhej të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, dispozitat e këtij neni do të zbatohen vetëm mbi shumën e përmendur në fund. Në këtë rast, pjesa që kalon pagesën normale do të mbetet e tatueshme në përputhje me ligjet e secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh edhe dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Të ardhurat nga e drejta e autorit (honoraret)

1. Honoraret (të ardhurat nga e drejta e autorit) që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe i

paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këto të ardhura mund të taten gjithashtu në Shtetin Kontraktues ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e këtij shteti, por nëse marrësi është pronari përfitues i honorareve, tatimi i ngarkuar nuk duhet të kalojë 10 për qind të shumës bruto të honorarit. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të vendosin me mirëkuptim reciprok për mënyrën e zbatimit të këtij kufizimi.

3. Termi “honorare” nën dispozitat e këtij neni nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të së drejtës së autorit për punimet letrare, artistike ose shkencore, përfshirë filmat kinematografikë dhe regjistrimet për transmetime radiotelevizive, çdo patentë, markë tregtare, skicë ose model, program kompjuterik, plan, proces ose formulë sekrete ose për përdorimin, ose për të drejtën e përdorimit të pajisjeve industriale, tregtare apo shkencore, ose për informacione lidhur me eksperiencën industriale tregtare apo shkencore.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk do të zbatohen nëse pronari përfitues i honorareve, duke qenë rezident i një Shteti Kontraktues, ushtron biznes në Shtetin tjetër Kontraktues, ku krijohen honoraret, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur aty, ose kryhen në atë shtet tjetër shërbime personale të pavarura nga një bazë fikse e vendosur aty, dhe e drejta ose prona lidhur me të cilën paguhen honoraret është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme ose bazë fikse. Në këtë rast do të zbatohen dispozitat e nenit 7 ose nenit 14, si të paraqitet rasti.

5. Honoraret do të konsiderohen se krijohen në një Shtet Kontraktues kur pagues është vetë ai shtet, një nënndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur personi që paguan honoraret, qoftë ose jo rezident i një Shteti Kontraktues, ka në njërin shtet Kontraktues një seli të përhershme ose një bazë fikse në lidhje me të cilën ka lindur e drejta e pagimit të honorareve, dhe këto honorare kanë lindur nga kjo seli e përhershme ose bazë fikse, atëherë këto honorare do të konsiderohen se kanë lindur në Shtetin Kontraktues ku është vendosur selia e përhershme ose baza fikse.

6. Kur për shkak të lidhjeve të veçanta midis paguesit dhe pronarit përfitues ose midis të dyve dhe personave të tretë, shuma e honorareve, duke pasur parasysh përdorimin, të drejtën apo informacionin për të cilin ato janë paguar, e kalon shumën për të cilën do të ishte rënë dakord midis paguesit dhe pronarit përfitues në mungesë të marrëdhënieve të tilla, atëherë dispozitat e këtij neni do të zbatohen mbi shumën e përmendur në fund. Në një rast të tillë shuma e shpërbimit që kalon shpërblimin normal mbetet e tatueshme sipas ligjeve përkatëse të secilit Shtet Kontraktues, duke pasur parasysh dispozitat e tjera të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Fitimet nga tjetërsimi i kapitalit

1. Fitimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga tjetërsimi i pasurive të paluajtshme që i referohen nenit 6 të kësaj Marrëveshjeje dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të taten në këtë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurive të luajtshme, që bëjnë pjesë në pasuritë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose i pasurive të luajtshme që i përkasin një baze fikse që një rezident i një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues për të kryer shërbime personale të pavarura, përfshirë edhe fitimet nga tjetërsimi i vetë selisë së përhershme (vetëm ose bashkë me sipërmarrjen) ose i bazës fikse, mund të taten në këtë shtet tjetër.

3. Fitimet e realizuara nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që veprojnë në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin veprimtarisë së këtyre anijeve ose avionëve, do të taten vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet vendi i drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve të kapitalit të një shoqërie, pasuria e së cilës konsiston, direkt ose indirekt, kryesisht në pasurinë e paluajtshme të vendosur në një Shtet Kontraktues, mund të taten në atë Shtet Kontraktues.

5. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie që nuk mbulohet nga paragrafët e mëparshëm të këtij neni, mund të taten në Shtetin Kontraktues ku krijohen këto të ardhura.

Neni 14

Shërbimet personale të pavarura

1. Të ardhurat e realizuara nga një individ i cili është rezident i një Shteti Kontraktues, lidhur me shërbime profesionale ose aktivitete të tjera të një karakteri të pavarur, do të tatohen vetëm në atë shtet përveç në rrethanat që vijojnë, kur të ardhura të tilla mund të tatohen gjithashtu edhe në Shtetin tjetër Kontraktues:

a) nëse ai ka një bazë fikse në dispozicion të tij në Shtetin tjetër Kontraktues, që rregullisht i shërben atij për të kryer aktivitetet e tij, në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave që i atribuohen kësaj baze fikse mund të tatohen në këtë Shtet tjetër Kontraktues;

b) nëse qëndrimi i tij në Shtetin tjetër Kontraktues është për një periudhë ose periudha që në total arrijnë ose kalojnë 183 ditë në çdo periudhë 12-mujore, që fillon ose përfundon në vitin përkatës kalendarik, në këtë rast, vetëm ajo pjesë e të ardhurave të realizuara nga aktivitetet e tij të kryera në këtë shtet tjetër mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Termi “shërbime profesionale” përfshin në veçanti aktivitetet e pavarura shkencore, letrare, artistike, arsimore apo mësimdhënieje, si dhe aktivitetet e pavarura të mjekëve, avokatëve, inxhinierëve, arkitektëve, dentistëve dhe llogaritarëve.

Neni 15

Shërbimet personale të varura

1. Pa cenuar dispozitat e neneve 16, 18, 19, 20 dhe 21, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues, nga punësimi i tij do të tatohen vetëm në këtë Shtet Kontraktues, përveç kur puna është ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues. Nëse puna ushtrohet në këtë mënyrë (pra në Shtetin tjetër Kontraktues), atëherë këto të ardhura mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Përjashtuar dispozitat e paragrafit 1, shpërblimet e përfituara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues do të tatohen vetëm në shtetin e përmendur në fillim në qoftë se plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:

a) Përfituesi (marrësi) është prezent në shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i kalojnë në total 183 ditë në vitin fiskal përkatës;

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi që nuk është rezident i shtetit tjetër;

c) shpërblimi nuk ka lindur nga një seli e përhershme ose bazë fikse që punëdhënësi ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht nga dispozitat e mëparëshme të këtij neni, shpërblimet e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues lidhur me punën e ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni që vepron në trafikun ndërkombëtar, mund të tatohen në Shtetin Kontraktues, në të cilin ndodhet qendra efektive e drejtimit të sipërmarrjes.

Neni 16

Shpërblimet e drejtorëve

Shpërblimet e drejtorëve dhe pagesa të tjera të ngjashme të realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues në pozitën e tij si anëtar i këshillit të drejtorëve ose çdo organi të ngjashëm të një shoqërie që është rezident i Shtetit tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

Neni 17

Artistët dhe sportistët

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 14 dhe 15, të ardhurat e realizuara nga një rezident i një Shteti Kontraktues si një artist, si aktor teatri, kinematografie, radiotelevizioni, muzikant apo si sportist, nga aktiviteti i tij personal si i tillë, i ushtruar në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat lidhur me aktivitetet personale të ushtruara nga një artist ose sportist në pozitën e tij si i tillë realizohen jo direkt nga sportisti apo artisti, por nga një person tjetër, këto të

ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7, 14 dhe 15, mund të taten në Shtetin Kontraktues në të cilin janë ushtruar aktivitetet e artistit apo sportistit.

Neni 18

Pensionet

Pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme që krijohen në një Shtet Kontraktues dhe që i paguhen një rezidenti të Shtetit tjetër Kontraktues lidhur me punësimin e tij në të kaluarën, do të taten vetëm në atë shtet.

Neni 19

Shërbimet qeveritare

1. a) Shpërblimet, të ndryshme nga pensionet, të paguara nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo nga një autoritet lokal atje një individ lidhur me shërbimet që ai i ka kryer atij shteti, nënndarje politike apo autoriteti, do të taten vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto shpërblime do të taten vetëm në Shtetin tjetër Kontraktues nëse shërbimet janë kryer në atë shtet dhe individ është rezident i atij shteti, i cili (individ):

i) është nënshtrës i atij shteti;

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2. Dispozitat e neneve 15, 16 dhe 18 do të zbatohen mbi shpërblimet dhe pensionet lidhur me shërbimet e kryera lidhur me një aktivitet biznesi të ushtruar nga një Shtet Kontraktues, një nënndarje politike apo autoritet lokal atje.

Neni 20

Pagesat e marra nga studentët dhe specialistët

Një rezident i një Shteti Kontraktues, që është përkohësisht prezent në Shtetin tjetër Kontraktues vetëm:

a) si një student në një universitet, kolegji ose shkollë;

b) si një specialist teknik apo biznesi;

c) si përfitues i një granti, burse apo shpërblimi, me qëllim primar studimin apo kërkimin prej një organizate fetare, bamirësie, shkencore apo arsimore;

nuk do të taten në atë shtet tjetër për çdo pagesë apo shpërblim që merr për të përballuar jetesën, arsimimin apo trajnimin, me kusht që pagesa apo shpërblime të tilla të kryhen nga burime jashtë këtij shteti tjetër.

Neni 21

Pedagogët, mësuesit dhe kërkuesit shkencorë

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues, i cili, me ftesë të një universiteti, kolegji ose institucioni tjetër shkencor që ndodhet në Shtetin tjetër Kontraktues, viziton këtë shtet tjetër me qëllim vetëm të mësimdhënies apo kërkimit shkencor për një periudhë që nuk i kalon dy vjet, nuk do të taten në këtë shtet tjetër për shpërblimet e marra për mësimdhënien apo kërkimin shkencor, me kusht që të tilla shpërblime të kryhen nga burime jashtë këtij shteti tjetër.

2. Dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni nuk do të zbatohen ndaj të ardhurave të realizuara nga puna kërkimore, e cila nuk kryhet për interesat publikë, por kryesisht për interesa personale të një personi apo personave të veçantë.

Neni 22

Të ardhura të tjera

1. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 2, lloje të ardhurash të një rezidenti të një Shteti Kontraktues, kudo që krijohen, që nuk lidhen me nenet e mëparshme të kësaj Marrëveshjeje, do të taten vetëm në atë shtet.

2. Megjithatë, nëse të ardhura të tilla realizohen nga një rezident i një Shteti Kontraktues nga

burime në Shtetin tjetër Kontraktues, këto të ardhura mund të tatohen gjithashtu në shtetin ku krijohen dhe në përputhje me ligjet e atij shteti.

Neni 23

Kapitali

1. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të paluajtshme që i referohen nenit 6, të zotëruara nga një rezident i një Shteti Kontraktues dhe të vendosura në Shtetin tjetër Kontraktues, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

2. Kapitali i përfaqësuar nga pasuri të luajtshme që bëjnë pjesë në pasurinë e biznesit të një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues ose nga pasuri të luajtshme që i përkasin një baze fikse në dispozicion të një rezidenti të një Shteti Kontraktues në Shtetin tjetër Kontraktues për kryerjen e shërbimeve personale të pavarura, mund të tatohen në këtë shtet tjetër.

3. Kapitali i përfaqësuar nga anijet dhe avionët që veprojnë në trafikun ndërkombëtar, si dhe pasuritë e luajtshme që i përkasin aktivitetit të këtyre anijeve dhe avionëve, do të tatohen vetëm në Shtetin Kontraktues në të cilin ndodhet qendra e drejtimit efektiv të sipërmarrjes.

4. Të gjitha elementet e tjera të kapitalit të një rezidenti të një Shteti Kontraktues do të tatohen vetëm në këtë shtet.

Neni 24

Eliminimi i tatimit të dyfishtë

1. Kur një rezident i një Shteti Kontraktues realizon të ardhura ose zotëron kapitale, të cilat, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të tatohen në Shtetin tjetër Kontraktues, Shteti Kontraktues i përmendur në fillim do të lejojë një reduktim nga tatimi mbi të ardhurat ose mbi kapitalin e atij rezidenti të një shume të barabartë me tatimin mbi të ardhurat ose mbi kapitalin e paguar në atë Shtet tjetër Kontraktues. Megjithatë, një reduktim i tillë nuk do të kalojë atë pjesë të tatimit mbi të ardhurat ose tatimit mbi kapitalin të llogaritur para dhënies së reduktimit, që i atribuohet sipas rastit të ardhurave ose kapitalit që mund të tatohet në atë Shtet tjetër Kontraktues.

2. Kur, në përputhje me çdo dispozitë të kësaj Marrëveshjeje, të ardhurat e realizuara ose kapitali i zotëruar nga një rezident i një Shteti Kontraktues përjashtohet nga tatimi në atë Shtet Kontraktues, megjithatë ky shtet, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi pjesën e mbetur të të ardhurave ose të kapitalit të këtij rezidenti, mund të marrë në konsideratë të ardhurat ose kapitalin e përjashtuar.

Neni 25

Mosdiskriminimi

1. Nënshetësit e një Shteti Kontraktues nuk do të jenë, në Shtetin tjetër Kontraktues, subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi dhe kërkesat e lidhura me të, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen nënshetësit e këtij Shteti tjetër Kontraktues në rrethana të njëjta.

2. Tatimi i një selie të përhershme që një sipërmarrje e një Shteti Kontraktues ka në Shtetin tjetër Kontraktues nuk do të jetë më pak i favorshëm në këtë Shtet tjetër Kontraktues sesa tatimi i ngarkuar ndaj sipërmarrjeve të këtij shteti tjetër, që ushtrojnë aktivitete të njëjta.

3. Asnjë dispozitë e këtij neni nuk mund të merret si detyrim i njërit Shtet Kontraktues për t'i garantuar rezidentëve të Shtetit tjetër Kontraktues zbritje personale, lehtësira apo reduktime tatimore që i garanton rezidentëve të shtetit të vet për gjendjen civile dhe përgjegjësitë familjare që ata kanë.

4. Sipërmarrjet e një Shteti Kontraktues, kapitali i të cilave është totalisht ose pjesërisht i zotëruar apo kontrolluar, direkt ose indirekt, nga një ose më shumë rezidentë të Shtetit tjetër Kontraktues, nuk do të jenë në shtetin e përmendur në fillim subjekt i ndonjë tatimi ose kërkesë të lidhur me të, që të jetë i ndryshëm ose më i rëndë sesa tatimi ose kërkesat e lidhura me të, të cilave u nënshtrohen ose mund t'u nënshtrohen sipërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur në fillim.

Neni 26

Procedura e mirëkuptimit reciprok

1. Kur një person mendon se veprimet e njërit apo e të dyja Shteteve Kontraktuese e rëndojnë apo do ta rëndojnë atë me tatime që nuk janë në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mënyrat e ankimit të parashikuara në legjislacionin e brendshëm të këtyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë rastin e tij autoriteteve kompetente të Shtetit Kontraktues rezident i të cilit ai është, ose nëse rasti tij lidhet me paragrafin 1 të nenit 25, ai mund t'ia paraqesë rastin Shtetit Kontraktues nënshtetas i të cilit ai është. Çështja duhet të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i rastit lidhur me tatimin që nuk është në përputhje me dispozitat e marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse kërkesa i duket e justifikuar dhe ai vetë nuk e ka të mundur arritjen e një zgjidhjeje të kënaqshme, do të përpiqet ta zgjidhë çështjen me mirëkuptim reciprok me autoritetin kompetent të Shtetit tjetër Kontraktues, me synim shmangien e tatimit që nuk është në përputhje me Marrëveshjen.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve e Kontraktuese do të përpiqen që me mirëkuptim reciprok të zgjidhin çdo vështirësi apo dyshim që lind nga interpretimi apo zbatimi i Marrëveshjes. Ato gjithashtu mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet kur një gjë e tillë nuk parashikohet nga Marrëveshja.

4. Një Shtet Kontraktues nuk ka të drejtë, pas kalimit të limiteve përkatëse kohore të përcaktuara në legjislacionin e tij të brendshëm dhe në asnjë rast pas kalimit të një periudhe pesëvjeçare nga përfundimi i periudhës tatimore në të cilën është realizuar e ardhura në fjalë, të rrisë bazën tatimore të një rezidenti të cilitdo Shteti Kontraktues, duke përfshirë elemente të të ardhurave që gjithashtu janë rënduar me tatim në Shtetin tjetër Kontraktues. Ky paragraf nuk do të zbatohet në raste mashtrimi, fshehjeje të qëllimshme apo neglizhimi.

Neni 27

Shkëmbimi i informacionit

1. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese do të shkëmbejnë informacionet e nevojshme për zbatimin e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje ose të ligjeve të brendshme të Shteteve Kontraktuese lidhur me tatimet që mbulon Marrëveshja, përderisa ato tatime nuk janë në kundërshtim me marrëveshjen, sidomos për parandalimin e mashtrimeve apo evazionit në këto tatime. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga neni 1. Çdo informacion i marrë nga një Shtet Kontraktues do të trajtohet si sekret, në të njëjtën mënyrë si informacioni i marrë nën legjislacionin e brendshëm të atij. Megjithatë, nëse informacioni konsiderohet si sekret në shtetin që e transmeton (jep) informacionin, ai do t'i serviret vetëm personave apo autoriteteve (përfshirë gjykatat dhe organet administrative) të përfshira në llogaritjen apo mbledhjen e tatimeve, me imponimin ose ndjekjet lidhur me shkeljet tatimore apo lidhur me ankesat ndaj tatimeve që mbulon Marrëveshja. Këto persona apo autoritete do ta përdorin informacionin vetëm për të tilla qëllime dhe mund ta servirin informacionin në procedurat apo vendimet gjyqësore.

2. Në asnjë rast dispozitat e paragrafit 1 nuk interpretohen në kuptimin që i imponojnë njërit prej Shteteve Kontraktuese detyrimin:

a) të zbatojë masa administrative në ndryshim me ligjet dhe praktikat administrative të atij shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

b) të japë informacione që ndalohen sipas ligjeve apo praktikës normale administrative të atij shteti apo të Shtetit tjetër Kontraktues;

c) të japë informacione që mund të nxirrnin një sekret tregtar, biznesor, industrial apo profesional ose proces tregtar apo informacione, zbulimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me rendin publik.

Neni 28
Funksionarët diplomatikë dhe konsullorë

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk cenojnë privilegjet fiskale të funksionarëve diplomatikë dhe konsullorë që rrjedhin nga rregullat e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare apo nga dispozitat e marrëveshjeve të veçanta.

Neni 29
Dispozita të përziera

1. Pa cenuar dispozitat e nenit 25, kjo Marrëveshje nuk do të interpretohet si kufizim për çfarëdo përjashtimi, reduktimi, kreditimi apo lejimi tjetër ekzistues apo i mëvonshëm i akorduar:

- a) nga ligjet e një Shteti Kontraktues në përcaktimin e tatimit të zbatuar nga ai shtet;
- b) nga çdo marrëveshje tjetër të përfunduar nga një Shtet Kontraktues.

2. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të pengojnë zbatimin e dispozitave të legjislacionit të brendshëm të secilit Shtet Kontraktues për tatimin e të ardhurave të personave lidhur me pjesëmarrjen e tyre në kompanitë jorezidente apo lidhur me evazionin fiskal.

3. Autoritetet kompetente të Shteteve Kontraktuese mund të konunikojnë direkt me njëri-tjetrin për zbatimin e Marrëveshjes.

Neni 30
Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e marrjes së njoftimit të fundit, që konfirmon kompletimin e procedurave ligjore të domosdoshme për hyrjen në fuqi të saj në të dyja Shtetet Kontraktuese.

2. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e saj do të fillojnë të kenë efekt:

- a) lidhur me tatimet e mbajtura në burim, për shumat e paguara ose të kredituara më ose pas ditës së parë të janarit në vitin kalendarik që pason vitin në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi;
- b) lidhur me tatimet e tjera për vitet tatimore që fillojnë më ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin Marrëveshja hyn në fuqi.

Neni 31
Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi pa kufizim, por secili Shtet Kontraktues mundet që, më ose përpara 30 qershorit të çdo viti kalendarik pas vitit në të cilin ajo hyn në fuqi, t'i dorëzojë Shtetit tjetër Kontraktues nëpërmjet kanaleve diplomatike një njoftim me shkrim për përfundimin e Marrëveshjes.

Në një rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së pasuri efekt:

- a) lidhur me tatimet e mbajtura në burim për shumat e paguara ose të kredituara më ose pas ditës së parë të janarit në vitin kalendarik që pason vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit;
- b) lidhur me tatimet e tjera për vitet tatimore që fillojnë më ose pas ditës së parë të janarit të vitit kalendarik që pason vitin në të cilin është dhënë njoftimi i përfundimit.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshjeje.

Bërë në Kajro, më 23 shkurt 2005, në dy kopje, në gjuhët shqipe, arabe dhe angleze, kur të tre tekstet janë me vlera të barabarta. Në rast mosmarrëveshjes në interpretim, ka përparësi teksti në gjuhën angleze.

L I G J
Nr.9441, datë 11.11.2005

**PËR PRODHIMIN, GRUMBULLIMIN, PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E QUMËSHTIT
DHE TË PRODUKTEVE ME BAZË QUMËSHTI**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim:

Të sigurojë prodhimin e qumështit në ferma, grumbullimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit të papërpunuar, të qumështit për konsum dhe të produkteve me bazë qumështi, prodhimin dhe tregtimin me cilësi të kontrolluar, sipas kërkesave dhe standardeve të tregut të brendshëm dhe të jashtëm.

Të realizojë kontroll për pajisjen me leje të fermave të prodhimit të qumështit dhe të qendrave të grumbullimit, standardizimit dhe përpunimit të tij.

Të garantojë sigurinë e konsumatorit për qumështin dhe produktet me bazë qumështi.

Neni 2

Fusha e zbatimit

Objekt i zbatimit të këtij ligji janë:

Fermat prodhuese, qendrat e grumbullimit, të standardizimit dhe përpunimit të qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi.

Lënda e parë, qumështi i papërpunuar, qumështi për konsum, produktet me bazë qumështi dhe shtesat (aditivët).

Ambalazhimi, etiketimi, magazinimi, transporti dhe kontrolli i qumështit për konsum njerëzor dhe i produkteve me bazë qumështi.

Neni 3

Përkufizime

Për qëllimet e këtij ligji, termit e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

“Fermë qumështi” është vendi ku mbarështohen një ose më shumë lopë, buallica, dhi ose dele, prej të cilave përfitohet qumështi.

“Prodhues qumështi” është një individ apo grup individësh, që ka/kanë nën kontroll prodhimin e të paktën tri lopëve ose të paktën 50 litrave qumështi në ditë, i cili i shitet një qendre grumbullimi a përpunimi.

“Qendër grumbullimi” është vendi ku grumbullohet qumështi i papërpunuar dhe ku, sipas rastit, qumështi ftohet dhe/ose filtrohet.

“Qendër standardizimi” është vendi ku qumështit të papërpunuar mund t’i bëhet skremimi ose mund t’i ndryshohet përmbajtja e përbërësve natyrorë të tij. Kjo qendër duhet të jetë veç nga qendrat e grumbullimit dhe ato të përpunimit.

“Qendër përpunimi” është vendi ku qumështi dhe/ose nënproduktet e tij trajtohen, përpunohen, paketohen dhe/ose ambalazhohen.

“Organe përgjegjëse” janë Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Shëndetësisë, me strukturat e tyre përkatëse.

“Trajtim termik” është trajtimi i qumështit të papërpunuar nëpërmjet ngrohjes, që sjell menjëherë një reaksion negativ të testit përkatës të miratuar.

“Termizim” është ngrohja e qumështit të papërpunuar për 15 sekonda në një temperaturë ndërmjet 57 gradë C dhe 68 gradë C.

Pas këtij trajtimi, testi përkatës i miratuar duhet të japë rezultat pozitiv.

“Paketim” është futja e qumështit ose e produkteve me bazë qumështi në materiale, që sigurojnë mbrojtjen e produktit nga ndotja, nga infeksionet, si dhe nga ndikimet, të cilat ulin cilësinë dhe vlerën ushqimore të tij dhe e bëjnë të përshtatshëm për ambalazhimin, nëse më pas i nënshtrohen magazinimit, transportit, tregtimit a përdorimit.

“Ambalazhim” është procesi i vendosjes së një ose më shumë produkteve, të paketuara ose jo, në ambalazh.

11. “Ambalazh” është çdo material që është në kontakt me prodhimin ushqimor, zakonisht i pakonsumueshëm, i cili e mbron atë nga ndotja, nga infeksionet, si dhe nga ndikimet që ulin cilësinë dhe vlerën ushqimore të tij dhe që e bën të përshtatshëm për transport, tregtim a përdorim.

12. “Enë hermetikisht e mbyllur” është ena e destinuar për mbrojtjen e produktit kundrejt depërtimit të mikroorganizmave, gjatë dhe pas trajtimit në temperaturë.

13. “Qumësht i papërpunuar” është produkti i përftuar nga sekretimi i gjendrave të qumështit të një ose më shumë lopëve, deleve, dhive apo buallicave, i cili nuk është ngrohur mbi 40 gradë C dhe që nuk i është nënshtuar asnjë veprimi me efekt të ngjashëm.

14. “Qumësht i destinuar për prodhimin e produkteve me bazë qumështi” është qumështi i përpunuar, i lëngshëm ose i ngrirë, i përftuar nga qumështi i papërpunuar, që i është nënshtuar një trajtimi termik ose termizimit dhe që mund të ketë ndryshuar përbërjen e tij, me kusht që ky ndryshim të ketë ndikuar në shtimin dhe/ose heqjen e përbërësve natyrorë.

15. “Qumësht për konsum” është qumështi i përftuar nëpërmjet trajtimit termik dhe që plotëson kushtet e përcaktuara në këtë ligj, i destinuar për shitje te konsumatori, qoftë individ apo kolektiv.

16. “Produkte me bazë qumështi” janë:

produkte qumështi, të përfthuara vetëm prej qumështit me shtesa të lëndëve të nevojshme për prodhimin e tyre, deri në masën që këto nuk zëvendësojnë, pjesërisht a plotësisht, përbërësit natyrorë të qumështit;

b) produkte të përbëra të qumështit, ku përbërësit natyrorë të qumështit nga shtesat e tjera nuk zëvendësohen dhe nuk nevojitet të zëvendësohen.

Në këto produkte, qumështi ose një produkt i tij përbën pjesën kryesore për nga sasia dhe për nga vetitë e produktit.

17. “Këshilli i Ekspertëve të Qumështit” është organi këshillimor i Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

18. “Leje për tregtimin e qumështit” është leja për tregtimin e qumështit të papërpunuar nga një fermë e kontrolluar qumështi në qendrat e grumbullimit, të standardizimit dhe të përpunimit.

19. “Leje për qendër grumbullimi të qumështit” është leja për vënien në përdorim të një qendre të kontrolluar grumbullimi të qumështit.

20. “Leje për qendër standardizimi të qumështit” është leja për vënien në përdorim të një qendre të kontrolluar standardizimi të qumështit.

21. “Leje për qendër përpunimi të qumështit” është leja për vënie në përdorim të një qendre të kontrolluar përpunimi ose trajtimi të qumështit.

Neni 4

Subjektet

1. Të gjithë personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj, të cilët ushtrojnë veprimtari në prodhimin, grumbullimin, standardizimin, përpunimin dhe tregtimin e qumështit dhe produkteve me bazë qumështi, u nënshtrohen kërkesave të këtij ligji.

2. Subjektet që ushtrojnë veprimtari, sipas pikës 1 të këtij neni, pajisen me leje përkatëse.

KREU II KËRKESAT PËR PAJISJE ME LEJE

Neni 5

Leje për tregtim qumështi

Një fermë qumështi pajiset me leje tregtimi kur plotëson kërkesat e shtojcës A të këtij ligji me titull “Kërkesat për pranimin e qumështit të papërpunuar në qendrat e përpunimit”.

Neni 6

Leje për qendër grumbullimi

Leja për qendër grumbullimi jepet kur plotësohen kushtet e krerëve I, II e III të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 7

Leje për qendër standardizimi

Leja për qendër standardizimi jepet kur plotësohen kushtet e krerëve I, II dhe IV të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 8

Leje për qendër përpunuese

Leja për qendër përpunuese jepet kur plotësohen kushtet e krerëve I, II, V dhe VI të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 9

Organet përgjegjëse për dhënien e lejeve

Organet përgjegjëse për dhënien e lejeve të përcaktuara në nenet 5, 6, 7 e 8 të këtij ligji janë: drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit në qarqe; drejtoritë e kujdesit shëndetësor parësor në qarqe.

KREU III QUMËSHTI I PAPËRPUNUAR

Neni 10

Kërkesa për qumështin e papërpunuar

Qumështi i papërpunuar, që destinohet për prodhimin e qumështit për konsum dhe të produkteve me bazë qumështi, grumbullohet në përputhje me dispozitat e krerëve I, II dhe III të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij ligji. Normat e grumbullimit të qumështit të papërpunuar përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Qumështi i përftuar nga kafshë në dukje të shëndetshme, që u përkasin tufave, zyrtarisht ose jo të prekura nga tuberkulozi apo bruceloza, përdoret për prodhimin e qumështit për konsum, të trajtuar termikisht, ose për prodhimin e produkteve me bazë qumështi, vetëm pasi t'i jetë nënshtruar përpunimit termik nën kontrollin e Inspektoratit Veterinar.

Për qumështin e deles dhe të dhisë, që destinohet për eksport, kryhet trajtimi termik në vend ose në pikën më të afërt përpunuese.

Qumështi i përftuar sipas pikës 2 të këtij neni grumbullohet dhe transportohet për në destinacion në enë të mbyllura, të etiketuara dhe me dokumentin shoqërues përkatës.

Neni 11

Shitja e qumështit të papërpunuar nga fermat e prodhimit të qumështit

Prodhuesi i qumështit lejohet të tregtojë qumështin e prodhuar në fermën e tij, në rast se është pajisur paraprakisht me leje tregtimi nga organet kompetente.

Qumështi i këtij prodhuesi duhet të plotësojë kërkesat e dispozitave të përcaktuara në nenin 10 të këtij ligji.

3. Qumështi lëndë e parë lejohet të tregtohet vetëm kur i është nënshtruar një përpunimi termik në qendrat e pajisura me leje për këtë qëllim.

KREU IV

QUMËSHTI PËR KONSUM

Neni 12

Kërkesa për qumështin për konsum

Qumështi për konsum përftohet nga qumështi i papërpunuar, i prodhuar në përputhje me nenin 10 të këtij ligji, që plotëson kërkesat si më poshtë:

pastrimi fizik i qumështit të jetë bërë sipas përcaktimit të shkronjës “d” të kreut V shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji;

qumështi i lopës të ketë:

përmbajtje yndyre jo më të vogël se 3,6 për qind;

pikë ngrirjeje jo më të lartë se $-0,520$ gradë C. Shmangiet nga kjo pikë ngrirjeje lejohen vetëm në rastet kur nga kontrollet e kryera nuk vërehen shtesa uji në qumështin e papërpunuar;

iii) densitet $1,028$ gr/litër, të përcaktuar për qumështin e plotë, në temperaturën 20 gradë C, ose ekuivalente me densitetin e përcaktuar për qumështin plotësisht të skremuar, në 20 gradë C;

iv) përmbajtja e proteinës të jetë jo më pak se 28 gr/litër, e llogaritur duke shumëzuar me $6,38$ përmbajtjen e azotit total të qumështit, shprehur në përqindje;

përmbajtje të lëndës së thatë, pa yndyrë, jo më pak se $8,5$ për qind.

2. Kërkesat teknike për prodhimin e qumështit për konsum përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Veprimtaria në qendrat e grumbullimit, të standardizimit dhe përpunimit të qumështit ushtrohet me leje, sipas kërkesave të përcaktuara në kreun II të këtij ligji dhe në shtojcën B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

4. Qumështi për konsum duhet të përmbushë kërkesat e sigurisë, të përcaktuara në nenin 16 të këtij ligji. Kërkesat për ngarkesat mikrobike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Kërkesat për treguesit cilësorë për qumështin për konsum përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Qumështi për konsum që tregtohet duhet të plotësojë këto kushte:

a) të jetë paketuar dhe etiketuar sipas neneve 18, 19 dhe 20 të këtij ligji;

b) të magazinohet dhe transportohet sipas neneve 21 dhe 22 të këtij ligji;

c) të shoqërohet gjatë transportimit me një dokumentacion shoqërues, në të cilin përcaktohet qartë edhe lloji i përpunimit termik.

KREU V

PRODUKTE ME BAZË QUMËSHTI

Neni 14

Qumështi i papërpunuar për prodhimin e produkteve me bazë qumështi

Qumështi i papërpunuar ose i termizuar, që përdoret për prodhimin e produkteve me bazë qumështi, duhet të përmbushë këto kushte:

- të jetë në përputhje me nenin 10 të këtij ligji;
- b) qendrat e grumbullimit ose të standardizimit, nëpër të cilat kalon qumështi i papërpunuar, të jenë të pajisura me leje, sipas kërkesave të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji;
- c) të jetë etiketuar, magazinuar e transportuar sipas neneve 18, 19, 21 dhe 22 të këtij ligji.

Neni 15

Kërkesat për tregtimin e produkteve me bazë qumështi

Produktet me bazë qumështi, të prodhuara nga qumështi, që plotëson kërkesat e nenit 10, ose nga një produkt tjetër qumështi, tregtohen kur:

a) prodhohen në një qendër përpunimi, të pajisur me leje përkatëse, sipas ligjit nr.7941, datë 31.5.1995 “Për ushqimin” dhe kërkesave të krerëve I, II, III dhe VI të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji;

b) të jenë në përputhje me normat për përmbajtjen, cilësinë dhe sigurinë ushqimore për qumështin e konsumit dhe produktet me bazë qumështi, të përcaktuara me vendime të Këshillit të Ministrave;

c) paketohen e ambalazhohen në përputhje me nenin 18 të këtij ligji dhe, nëse janë në formë të lëngshme e të destinuara për shitje te konsumatori, duhet të plotësojnë kërkesat për paketim dhe ambalazhim, të përcaktuara në pikën 1 të kreut VII të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji;

ç) etiketohen sipas nenit 19 të këtij ligji;

d) magazinohen e transportohen sipas neneve 21 e 22 të këtij ligji;

dh) i nënshtrohen një përpunimi termik gjatë prodhimit ose të jenë prodhuar nga produkte, që i janë nënshtruar, paraprakisht, një përpunimi termik, në kushte të mjaftueshme për të plotësuar kriteret higjieno-veterinare dhe higjieno-sanitare, për garantimin e sigurisë ushqimore në produktin përfundimtar;

e) janë prodhuar me shtesa ushqimore, të përcaktuara vetëm për konsumin njerëzor, sipas nenit 16 të këtij ligji.

ë) plotësojnë kërkesat e pikës 3 të nenit 13 të këtij ligji për dokumentet shoqëruese.

Neni 16

Përpunimi i produkteve me bazë qumështi me shtesa ushqimore

Nëse në qendrat e përpunimit të qumështit bëhet prodhimi i produkteve me bazë qumështi me shtesa të tjera ushqimore, këto të fundit duhet të jenë të miratuara, sipas kreut II të ligjit “Për ushqimin”.

Gjatë procesit të prodhimit të respektohen rregullat higjieno-sanitare, higjieno-veterinare dhe tekniko-teknologjike, të përcaktuara në shtojcat, që i bashkëlidhen këtij ligji.

Neni 17

Mbetjet në qumësht dhe në produktet me bazë qumështi

Organi përkatës përgjigjet për hartimin dhe zbatimin e programit për testimin dhe mbikëqyrjen sistematike të qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi. Ky program siguron që mbetjet e substancave, me veprim farmakologjik ose hormonal, si antibiotikët, pesticidet, detergjentët dhe të tjera, nuk i kalojnë kufijtë e përcaktuar në legjislacionin përkatës.

Qumështi ose produktet me bazë qumështi, me përmbajtje më të lartë të mbetjeve të substancave të përmendura në pikën 1 të këtij neni, ndalohet të përdoren për konsum njerëzor.

KREU VI

AMBALAZHIMI DHE ETIKETIMI

Neni 18

Paketimi dhe ambalazhimi i qumështit dhe i produkteve me bazë qumështi kryhen sipas nenit 17 të ligjit “Për ushqimin” dhe kreut VII të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 19

Etiketimi i qumështit dhe i produkteve me bazë qumështi bëhet në përputhje me nenin 18 të ligjit “Për ushqimin” e me aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe kreut IX të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 20

Vula e prodhuesit

Qumështi dhe produktet me bazë qumështi i nënshtrohen vendosjes së vulës së prodhuesit, veprim i cili realizohet në fabrikë, në çastin e prodhimit ose menjëherë pas tij.

Vendosja e vulës, forma dhe përmbajtja e saj bëhen sipas përcaktimeve të kreut VIII të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

KREU VII

PAJISJET, MJEDISET E PUNËS, MAGAZINIMI DHE TRANSPORTI I QUMËSHTIT DHE I PRODUKTEVE ME BAZË QUMËSHTI

Neni 21

Autocisternat, autobotet e qumështit, impiantet, enët (pajisjet), si dhe mjediset që përdoren për përpunimin e qumështit mund të përdoren për produkte të tjera ushqimore të lëngshme. Në rastet e ripërdorimit të shmanget ndikimi i tyre në cilësinë dhe sigurinë e qumështit dhe të produkteve të tij.

Autocisternat dhe autobotet e qumështit regjistrohen pranë drejtorive rajonale të bujqësisë dhe ushqimit dhe mbi to vendoset qartë shënimi i veçantë “Produkte ushqimore”. Ato lejohen të përdoren vetëm për transportin e produkteve ushqimore.

Neni 22

Magazinimi, ruajtja dhe transporti i qumështit dhe i produkteve me bazë qumështi bëhen sipas legjislacionit në fuqi dhe kreut X të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Në rast se një qendër përpunimi prodhon produkte ushqimore, që përmbajnë qumësht ose produkte qumështi bashkë me shtesa të tjera teknologjike (ingredientë), që nuk i janë nënshtruar trajtimit termik ose një trajtimi me efekt të njëjtë, qumështi dhe produktet e tjera të qumështit magazinohen veçmas, për të mënjeluar ndotjet e ndërsjella. Qumështi dhe produktet e tjera të qumështit trajtohen ose përpunohen në mjedise të përshtatshme.

Neni 23

Kërkesat higjienike të personelit

Personeli punonjës, që merret me trajtimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi, është i detyruar të respektojë kërkesat e nenit 11 të ligjit “Për ushqimin” dhe ato të shkronjës “B” të kreut II të shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

KREU VIII KONTROLLI

Neni 24

Organet e kontrollit

Organet përgjegjëse të kontrollit janë:
inspektoratet në drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;
inspektoratet në drejtoritë rajonale të bujqësisë dhe të ushqimit në qarqe;

inspektoratet sanitare shtetërore në drejtoritë e kujdesit shëndetësor parësor në qarqe.

Neni 25

Kontrollet periodike

Qendrat e grumbullimit, të standardizimit dhe përpunimit të qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi i nënshtrohen një kontrolli periodik nga organet përgjegjëse, në përputhje me kreun VII të ligjit “Për ushqimin” dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe me kërkesat e shtojcës B, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 26

Kontrolli veterinar

Kafshët e fermës dhe ferma prodhuese i nënshtrohen kontrollit veterinar periodik, në zbatim të ligjit “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar” dhe të krerëve I, II e III të shtojcës A, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 27

Kontrolli dhe vetëkontrolli

Inspektorati i Ushqimit kontrollon zbatimin e kushteve dhe të kriterëve që parashikon ky ligj dhe përshtatjen e procedurave të vetëkontrollit, që zbatohen në të gjitha fazat e përpunimit, sipas kreut VII të ligjit “Për ushqimin”.

Drejtuesi i qendrës së përpunimit është i detyruar të zotërojë një sistem vetëkontrolli.

Mënyra e organizimit dhe kriteret e vetëkontrollit nga prodhuesi përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 28

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, me strukturat vartëse, harton regjistrin shtetëror të qendrave të përpunimit, të grumbullimit dhe të standardizimit të qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi.

Forma e regjistrit dhe kriteret për regjistrimin e këtyre qendrave përcaktohen me rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

Neni 29

Kërkesat për importimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi

Kërkesat që zbatohen për importimin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi duhet të jenë të njëjta ose më të larta se kërkesat e përcaktuara në këtë ligj për prodhimin vendas, sipas përcaktimeve të organit përgjegjës.

KREU IX

KËSHILLI I EKSPERTËVE TË QUMËSHTIT

Neni 30

Pranë Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit ngrihet Këshilli i Ekspertëve të Qumështit. Organizimi, funksionimi, struktura dhe detyrat e tij përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU X

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 31

Përcaktimi i kundërvajtjeve administrative

Sipas këtij ligji, në rastet kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative shkeljet e dispozitave të mëposhtme:

Mosrespektimi i kërkesave për qumështin e papërpunuar, sipas përcaktimeve të nenit 10 të këtij ligji.

2. Tregtimi i qumështit të papërpunuar nga fermat e prodhimit, pa lejen e tregtimit, të lëshuar nga organet përkatëse, të parashikuara në nenin 11 të këtij ligji.

3. Mosrespektimi i kërkesave për qumështin për konsum, sipas përcaktimeve të neneve 12 e 13 të këtij ligji.

4. Mosrespektimi i kërkesave për qumështin e papërpunuar për prodhimin e produkteve me bazë qumështi, sipas përcaktimeve të nenit 14 të këtij ligji.

5. Mosrespektimi i kërkesave për tregtimin e produkteve me bazë qumështi, sipas përcaktimeve të nenit 15 të këtij ligji.

6. Mosrespektimi i kërkesave të ambalazhimit dhe të etiketimit të qumështit dhe produkteve të tij, sipas përcaktimeve të neneve 18 e 19 të këtij ligji.

7. Mosrespektimi i kërkesave për magazinimin e qumështit dhe të produkteve të tij, sipas përcaktimeve të nenit 22 të këtij ligji.

8. Prodhimi, grumbullimi, përpunimi dhe standardizimi i qumështit pa lejet përkaëse, të përcaktuara në nenet 5, 6, 7 e 8 të këtij ligji.

Neni 32

Sanksionet

Për kundërvajtjet administrative, të parashikuara në nenin 31 të këtij ligji, nga organet e kontrollit jepen këto sanksione:

për shkeljet e parashikuara në pikat 1, 3, 4 e 5, masa e gjobës është 50 000 lekë;

për shkeljet e parashikuara në pikat 2 e 8, masa e gjobës është 100 000 lekë;

c) për shkeljet e parashikuara në pikat 6 e 7, masa e gjobës është 30 000 lekë.

Neni 33

Organet përgjegjëse për vendosjen e masave administrative

Të drejtën e vendosjes së masave administrative, për shkeljet e parashikuara në nenin 31 të këtij ligji, e kanë:

Inspektorati i Ushqimit;

Inspektorati i Veterinarisë;

Inspektorati i Zooteknisë;

ç) Inspektorati Sanitar.

Procedurat e ankimit dhe të ekzekutimit të masave administrative bëhen në përputhje me ligjet “Për ushqimin”, “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”, “Për ushqimet e blegtorisë” dhe “Për Inspektoriatin Sanitar Shtetëror”.

KREU XI

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 34

Kufizime dhe detyrime

Ky ligj nuk prek shitjen e drejtpërdrejtë nga ferma të konsumatori të qumështit të papërpunuar, që vjen nga tufa të certifikuara zyrtarisht, si dhe shitjen e produkteve të prodhuara drejtpërdrejt nga ky qumësht në fermë, duke respektuar nenin 10 dhe nenin 11 pikat 2 dhe 3 të këtij ligji.

Neni 35

Afatet

Prodhuesit e qumështit të papërpunuar pajisen me leje brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Në qendrat e grumbullimit dhe të përpunimit, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të plotësohen kushtet e përgjithshme dhe të veçanta higjienike, sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën B, që i bashkëlidhet këtij ligji, për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë përkatëse.

Neni 36

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të neneve 10 pika 1, 12 pikat 2, 4 e 5 dhe 30 të këtij ligji.

Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të nxjerrë rregulloret në zbatim të neneve 27 pika 2 e 28 pika 2 të këtij ligji.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4706, datë 30.11.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

KËRKE

SHTOJCA A
SAT PËR PRANIMIN E QUMËSHTIT TË PAPËRPUNUAR
NË QENDRAT E PËRPUNIMIT

KREU I
KËRKESAT E SHËNDETIT TË KAFSHËS PËR QUMËSHTIN E PAPËRPUNUAR

1. Qumështi i papërpunuar duhet të përftohet prej kafshëve:
Lopë dhe buallicë:
a1) Të cilat u përkasin tufave:
(1) zyrtarisht të shëndosha nga tuberkulozi;
të paprekura ose zyrtarisht të paprekura nga bruceloza.
a2) Të cilat nuk shfaqin shenja të sëmundjeve ngjitëse, të transmetueshme te njeriu nëpërmjet qumështit.
a3) Të cilat nuk transmetojnë në qumësht karakteristika organo-shqisore anormale.
a4) Gjendja e përgjithshme shëndetësore e të cilave nuk shoqërohet me çrregullime të dukshme dhe që nuk vuajnë nga infeksione të aparatit gjenital me rrjedhje, nga sëmundje të aparatit tretës të shoqëruara me diare dhe temperaturë ose nga infeksione të dallueshme të gjirit.
a5) Të cilat nuk kanë plagë të gjirit, që mund të ndikojnë negativisht në qumësht.
a6) Të cilat, në rastin e lopëve, duhet të japin të paktën dy litra qumësht në ditë.
a7) Të cilat nuk janë trajtuar me lëndë të rrezikshme ose që njihen si të rrezikshme për shëndetin e njeriut, të afta të kalojnë në qumësht, ose qumështi i të cilave nuk është përfituar pas afatit zyrtar të pritjes, të vendosur në dispozitat e ligjit nr.9308 datë 4.11.2004 “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”.
b) Dele e dhi:
b1) Të cilat i përkasin një tufe të paprekur ose zyrtarisht të paprekur nga bruceloza.
b2) Të cilat përmbushin kërkesat e pikës (a) më sipër, me përjashtim të pikave a1 dhe a6.
2. Nëse mbahen në një fermë së bashku me kafshë të llojeve të ndryshme, atëherë çdo lloj i tyre duhet të përmbushë kërkesat për kushtet shëndetësore, të cilat do të kërkoheshin edhe për mbarështim të veçantë të tyre.
3. Nëse mbahen në një fermë së bashku dhi dhe lopë, dhitë t’i nënshtrohen kontrollit për tuberkulozin nga Inspektorati Veterinar, sipas ligjit “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”.
4. Qumështi i papërpunuar nuk lejohet të çohet për përpunim, për shitje dhe për konsum nëse ai:
a) është përftuar nga kafshë të trajtuara ilegalisht me lëndë të papërshtatshme, të përcaktuara nga ligji “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”, si ato me veprim hormonal apo me veprim mbi hormonet e tiroides;
b) kur përmban mbetje lëndësh të përcaktuara sipas dispozitave të nenit 17 të këtij ligji, mbi nivelin e vlerave të lejuara.

KREU II
KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR FERMË QUMËSHTI

1. Qumështi i papërpunuar duhet të vijë nga ferma të regjistruara e të kontrolluara sipas këtij ligji. Nëse nuk mbarështohen ekstensivisht, stallat duhen vendosur, ndërtuar, mirëmbajtur dhe administruar që të realizojnë sa e si më poshtë:
kushte të plota të strehimit, higjienës, pastërtisë dhe shëndetit të kafshëve;
kushte higjienike të kënaqshme për mjeljen, trajtimin, ftohjen e depozitim të qumështit.
2. Lokalet, në të cilat kafshët milen ose ku qumështi ruhet, trajtohet ose ftohet, të vendosen e të pajisen në atë mënyrë, që të përjashtohet çdo rrezik ndotjeje i qumështit. Ato të jenë të pastrueshme e të dezinfektueshme lehtë dhe të plotësojnë kushtet si më poshtë:
muret dhe dyshemeja të jenë lehtësisht të pastrueshme në zonat që paraqesin rrezik ndotjeje ose infeksioni;
b) dyshemeja të jetë shtruar në atë mënyrë që ujërat të rrjedhin pa vështirësi dhe të jetë e mundur një eliminim i rregullt i papastërtive;

të kenë ventilim dhe ajrim të kënaqshëm;

ç) të kenë një implant furnizimi të përshtatshëm e të mjaftueshëm për ujë të pijshëm për përdorimin gjatë mjeljes, pastrimin e mjeteve dhe pajisjeve, sipas kreut III shkronja B pika 2 e kësaj Shtojce;

të kenë distanca të mjaftueshme nga vendet e ndotjes, si banjo dhe kavaletat e plehut;

dh) të kenë pajisje e mjete që lahen, pastrohen e dezinfektohen lehtë. Përveç kësaj, dhomat e ruajtjes së qumështit duhet të kenë pajisjet e nevojshme për ftohjen e qumështit menjëherë pas mjeljes, të jenë të mbrojtura nga insektet dhe të jenë të ndara në mënyrë të mjaftueshme nga strehimet e kafshëve.

Në rast të përdorimit të një pajisjeje mjelëse të lëvizshme, duhen plotësuar kërkesat sipas pikës 2 shkronjat “ç” dhe “dh” të këtij kreu. Përveç kësaj, pajisja duhet:

a) të vendoset në bazament që nuk lejon grumbullimin e eksrementeve ose të mbeturinave të tjera;

b) të realizojë një mbrojtje të qumështit gjatë përdorimit të saj;

c) të ndërtohet dhe të pajiset në atë mënyrë që sipërfaqet e brendshme të mbahen të pastra.

Në rast të mbajtjes së lopëve në stallë në gjendje të lirë (të zgjidhura), vendi i mjeljes të jetë i ndarë në mënyrë të mjaftueshme nga stalla.

Kafshët, të cilat janë prekur nga një sëmundje ose dyshohen të jenë prekur nga një e tillë, sipas kreut I shkronjat a1 dhe a3 të kësaj Shtojce, të ndahen nga pjesa tjetër e tufës në mënyrë sa më të efektshme.

Kafshët e të gjitha llojeve të mbahen larg vendeve ku qumështi ruhet, trajtohet ose ftohet.

KREU III

KËRKESAT PËR MJELJEN GRUMBULLIMIN DHE TRANSPORTIN E QUMËSHTIT TË PAPËRPUNUAR NGA FERMA PRODHUESE NË QENDRAT E GRUMBULLIMIT, STANDARDIZIMIT OSE NË QENDRËN E PËRPUNIMIT. HIGJIENA E PERSONELIT

Kërkesa për mjeljen

Mjelja të bëhet duke respektuar të gjitha kushtet higjienike, sipas dispozitave të ligjit “Për shërbimin dhe Inspektoratin Veterinar”.

Menjëherë pas mjeljes qumështi vihet në një vend të pastër, i cili është i tillë që shmang çdo ndikim negativ mbi cilësinë e qumështit. Nëse qumështi nuk grumbullohet brenda dy orëve nga mjelja, ai ftohet në temperaturën 8 gradë C apo më pak në rast të grumbullimeve ditore ose 6 gradë C kur grumbullimi nuk është ditor. Kur transportohet për në qendrën e trajtimit dhe/ose përpunimit temperatura e qumështit të ftohur nuk duhet t’i kalojë 10 gradë C, nëse qumështi nuk është grumbulluar brenda dy orëve nga mjelja.

B. Kërkesa higjienike për lokalet, pajisjet e mjetet

1. Pajisjet e mjetet që janë caktuar për të pasur kontakt me qumështin (enët, mbajtëset e qumështit, rezervuarët që përdoren për mjeljen, grumbullimin e transportin), përkatësisht, të jenë prodhuara nga material me sipërfaqe të lëmuar, i lehtë për t’u pastruar e dezinfektuar, i qëndrueshëm ndaj korrozionit dhe që nuk lëshon lëndë në qumësht në sasi të tillë që mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe në përbërjen e qumështit ose në vetitë e tij organo-shqisore.

2. Pas përfundimit të mjeljes, të pastrohen e të dezinfektohen enët e mjeljes, makinat mjelëse mekanike dhe enët mbajtëse që janë në kontakt me qumështin, tanket dhe kontenierët e qumështit të përdorur për transportin e tij për në qendrën e grumbullimit, standardizimit ose përpunimit, pas çdo serie përdorimi, gjatë së cilës ka vetëm hapësira të vogla kohore nëpërmjet zbrazjes dhe mbushjes pasardhëse, të pastrohen dhe të dezinfektohen sa më shpejt të jetë e mundur ose të paktën një herë në ditë, si dhe përpara se ato të përdoren përsëri.

C. Kërkesa higjienike për personelin

1. Nga personeli kërkohet higjienë e plotë. Veçanërisht të respektohen rregullat si më poshtë: personat që bëjnë mjeljen dhe trajtimin e mëtejshëm të qumështit të papërpunuar duhet të veshin veshje pune të pastra e të përshtatshme;

mjelësit të lajnë e të dezinfektojnë duart detyrimisht para mjeljes e mundësisht t'i mbajnë të pastra gjatë mjeljes. Për këtë qëllim në vendin e mjeljes të parashikohet një vend për larjen e duarve dhe dezinfektimin e tyre, në mënyrë që personat që kryejnë mjeljen të kenë të mundur larjen dhe dezinfektimin e krahëve.

2. Punëdhënësi të interesohet që personat të cilët mund të infektojnë qumështin të përjashtohen nga trajtimi i qumështit të papërpunuar, derisa të vërtetohet që këta persona mund ta trajtojnë qumështin pa rrezik ndotjeje.

Të gjithë personat që trajtojnë qumështin, të pajisen me certifikatë mjekësore, që të provojnë se nga ana mjekësore nuk kanë pengesa për të punuar në këtë sektor. Vrojtimi mjekësor i tyre bëhet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

Ç. Kërkesa higjienike për prodhimin

1. Për të ndaluar shtesën e ujit në qumësht, nga Inspektoriati i Kontrollit përpilohen rregullat e kryerjes së kontrollit. Ky rregull kontrolli përfshin veçanërisht përcaktimin e rregullit të pikës së ngrirjes së qumështit në çdo fermë qumështi, sipas këtyre mënyrave:

a) qumështi i papërpunuar i çdo ferme qumështi të kontrollohet rregullisht me mostra të rastësishme. Nëse transportohet qumështi i papërpunuar vetëm i një ferme qumështi direkt në një qendër përpunimi, këto mostra duhen marrë kur qumështi është grumbulluar nga ferma, me kusht që të merren masa për parandalimin e falsifikimit gjatë transportit. Kur qumështi dorëzohet direkt nga punonjësi i fermës në qendrën përpunuese, prova merret direkt përpara shkarkimit;

b) kur mbi bazën e rezultateve të analizave inspektori i kontrollit dyshon për shtesa të ujit, merret në fermë një mostër origjinale. Mostër origjinale quhet një mostër që përfaqëson qumështin e një mjeljeje të plotë të mëngjesit ose darkës, të mbikëqyrur plotësisht, të kryer në jo më pak se 11 dhe në jo më shumë se 13 orë pas mjeljes së mëparshme;

c) në rast se qumështi grumbullohet nga shumë ferma, mostra mund të merret edhe vetëm në momentin e pranimit të qumështit në qendrën e përpunimit, në qendrën e grumbullimit ose standardizimit, me kusht që ndërkohë dhe në ferma merren mostra të rastësishme.

Nëse mbi bazën e rezultateve të analizave ngrihet dyshimi për shtesë uji, merren mostra në të gjitha fermat nga të cilat është grumbulluar qumësht në këtë parti.

Në rastet e nevojshme, Inspektoriati i Kontrollit merr mostra origjinale, sipas procedurës së përcaktuar në paragrafin e dytë të kësaj shkronje;

ç) nëse rezultatet e kontrollit tregojnë se nuk ka shtesë uji, qumështi i papërpunuar mund të përdoret: për qumësht konsumi, qumësht të trajtuar termikisht, si dhe për prodhimin e produkteve me bazë qumështi, të destinuar për konsum njerëzor.

2. Qendra përpunuese ose/dhe transformuese njofton menjëherë Inspektoratin e Kontrollit, sapo të diktojnë që janë arritur normat më të larta të lejuara të përmbajtjes së mikroorganizmave e të qelizave somatike, të përcaktuara me vendimin e Këshillit të Ministrave "Normat për grumbullimin e qumështit të papërpunuar", lidhur me përmbajtjen e mikroflorës së përgjithshme dhe qelizave somatike në zbatim të këtij ligji. Inspektoriati i Kontrollit merr masat e nevojshme.

3. Nëse brenda tre muajve nga shpallja e rezultateve të kontrollit, qumështi i fermës në fjalë nuk plotëson standardet, sipas pikës 1 shkronja "a" dhe kontrolleve, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave "Normat për grumbullimin e qumështit të papërpunuar", lidhur me përmbajtjen e mikroflorës së përgjithshme dhe qelizave somatike, në zbatim të këtij ligji, ferma përjashtohet nga dorëzimi i qumështit për një afat derisa qumështi t'u përgjigjet standardeve të mësipërme.

4. Nuk lejohet për konsum njerëzor qumështi, përmbajtja e të cilit në mbetjet e antibiotikëve është në sasi të tilla që kalon nivelet e përcaktuara, për secilën nga substancat e antibiotikëve të përcaktuara në ligjin "Për ushqimin". Sasia totale e mbetjeve të të gjitha substancave të antibiotikëve, gjithashtu, nuk lejohet të kalojë limitin që përcaktohet në ligjin "Për ushqimin".

SHTOJCA B

KREU I

KUSHTE TË PËRGJITHSHME PËR DHËNIEN E LEJES QENDRAVE TË PËRPUNIMIT

Qendrat përpunuese të qumështit, që të pajisen me leje, duhet të plotësojnë kushtet si më poshtë:

1. Repartet e punës të kenë hapësira të mjaftueshme, të cilat mundësojnë kryerjen e proceseve të punës në kushte higjienike të përshtatshme. Këto hapësira pune të projektohen dhe të paraqiten në atë mënyrë që të përjashtojnë çdo ndotje të lëndës së parë dhe produkteve të përkufizuara si produkte qumështi në këtë ligj.

Prodhimi i qumështit të trajtuar termikisht ose prodhimi i produkteve me bazë qumështi, të cilat sjellin me vete rrezikun e ndotjes për produktet e tjera të përkufizuara në këtë ligj, të kryhen në një vend të veçantë e të ndarë në mënyrë të qartë.

2. Në repartet ku manipulohen, përgatiten dhe përpunohen lëndë të para dhe produkte me bazë qumështi të mbuluara nga ky ligj, duhet që:

a) dyshemeja të jetë nga material i papërshkueshëm, i qëndrueshëm, i lehtë për pastrim e dezinfektim, që mundëson një rrjedhje të ujërave dhe ka sistemin e largimit të tyre;

b) muret të jenë me sipërfaqe të lëmuar, që pastrohet me lehtësi, të papërshkueshme, të qëndrueshme, të veshura me një material me ngjyrë të lehtë;

c) tavani të jetë lehtësisht i pastrueshëm në dhomat në të cilat trajtohen dhe përgatiten lëndët e para ose produktet e papaketuara që janë të ekspozuara;

ç) dyert të jenë të prodhuara nga material që nuk ndryshket e lehtësisht të pastrueshme;

d) të ketë një sistem për ajrosje të mjaftueshme dhe, nëse është e nevojshme, një sistem të përshtatshëm për largimin e avujve dhe tymrave;

dh) të ketë një ndriçim të mjaftueshëm natyral ose artificial;

e) të ketë një numër të mjaftueshëm pajisjesh hidrosanitare, të cilat të kenë ujë të rrjedhshëm, të ftohtë, të ngrohtë ose të parapërzier në një temperaturë të përshtatshme për pastrimin dhe dezinfektimin e duarve. Në dhomat e punës e në banjot nuk lejohet të preken rubinetat me dorë dhe në lavamanë të ketë lëndë pastruese, dezinfektuese, si dhe mjete higjienike për tharjen e duarve;

ë) të kenë pajisje për pastrimin e veglave të punës, të makinerive e të linjave.

Në qendrat e përpunimit të plotë duhet të ketë dhoma për depozitimin e lëndëve të para e produkteve me të njëjtat kushte si në pikën 2, si dhe:

a) dhoma për ruajtje në të ftohtë, ku dyshemeja të jetë me material të pastrueshëm e të dezinfektueshëm lehtë dhe ku uji mund të rrjedhë e të largohet lehtë;

b) dhoma për depozitim në ngrirje ose tejngrirje, ku dyshemeja të jetë nga material i papërshkueshëm nga uji, i pandryshkshëm dhe i pastrueshëm lehtësisht.

Në këtë rast duhet të jetë në dispozicion një pajisje me rendiment të mjaftueshëm ftohjeje, e cila garanton që lënda e parë dhe produktet të ruhen në temperaturat që parashikohet në këtë ligj.

Përdorimi i mureve të drurit në dhomat e prodhimit, të cilat janë ndërtuar para daljes së këtij ligji, nuk justifikon heqjen e lejes së prodhimit (licencës). Për ndërrimin e tyre lihet një afat 1-3 vjeçar.

4. Kapaciteti i dhomave depozituese duhet të jetë i mjaftueshëm për depozitimin e lëndëve të para dhe produkteve. Ato duhet të kenë:

a) pajisje për ruajtjen e higjienës, mbrojtjen e lëndës së parë dhe produkteve të paambalazuara gjatë procesit të ngarkim-shkarkimit;

b) mjete të përshtatshme për mbrojtjen nga insektet;

c) instrumente dhe pajisje pune, të cilat kanë kontakte të drejtpërdrejta me lëndën e parë dhe produktet të jenë nga materiale të qëndrueshme ndaj korrozionit, të pastrueshme dhe të dezinfektueshme lehtësisht;

ç) enë mbajtëse të veçanta, të papërshkueshme nga uji, prej materiali të qëndrueshëm ndaj korrozionit, për vendosjen e lëndëve të para ose produkteve që nuk destinohen për konsum njerëzor. Nëse këto produkte eliminohen me tuba shkarkimi, atëherë këto duhet të ndërtohen e të instalohen në mënyrë të tillë që të përjashtohet çdo rrezik ndotjeje për produktet e tjera;

d) pajisje të përshtatshme për pastrimin e dezinfektimin e materialeve dhe mjeteve të punës;

dh) një sistem të përshtatshëm për largimin e ujërave të përdorura, që plotëson kriteret

higjienike;

e) një implant furnizimi me ujë të pijshëm. Për prodhimin e avullit, për luftën kundër zjarrit dhe për ftohje lejohet vetëm me përjashtime, të përdoret ujë tjetër pa vetitë e ujit të pijshëm në rastet kur ai nuk paraqet asnjë rrezik kontaminimi direkt ose indirekt të lëndës së parë ose produkteve. Tubat që përdoren për kalimin e ujit që nuk zotëron vetitë e ujit të pijshëm duhet të ndryshojnë dukshëm me ato të ujit të pijshëm;

ë) një numër të mjaftueshëm të dhomave të veshjes (garderobave) me mure e dysHEME të lëmuar, të padepërtueshme dhe lehtësisht të pastrueshme, pajisje hidrosanitare, si dhe banjo me ujë të rrjedhshëm. Këto të fundit nuk lejohen të kenë dalje direkte në mjediset e punës;

f) një dhomë të veçantë për depozitimin e lëndëve larëse, dezinfektuesve ose lëndëve të ngjashme me to;

g) një dhomë ose një dollap, i cili të jetë jashtë mjediseve të punës, për materialet e pastrimit e të mirëmbajtjes;

gj) pajisje të përshtatshme për pastrimin e dezinfektimin e cisternave të përdorura për transportin e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi, të lëngshme ose në formë pluhuri. Nuk janë të detyrueshme këto pajisje nëse mjetet transportuese pastrohen e dezinfektohen në impiante të njohura zyrtarisht nga organet kompetente.

KREU II KUSHTET E PËRGJITHSHME HIGJIENIKE PËR QENDRAT E PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT

A. Kushtet e përgjithshme higjienike për lokalet, pajisjet dhe mjetet e punës

1. Pajisjet e mjetet e punës që përdoren për trajtimin e lëndëve të para dhe produkteve, dysHEMETË, muret, tavanet duhet të mbahen të pastra dhe në gjendje të mirë, që të shmangët çdo ndotje e lëndëve të para ose e produkteve.

2. Në mjediset e prodhimit dhe depozitimit të qumështit e produkteve të tij nuk lejohet të hyjë asnjë lloj kafshe. Brejtësit, insektet dhe dëmtues të tjerë duhet të luftohen sistematikisht. Helmi i minjve e insekteve, lëndët e mjetet dezinfektuese dhe lëndët e tjera helmuese duhet të mbahen në dhoma ose në dollapë të mbyllur me çelës; është detyrues që ato të përdoren në atë mënyrë që të përjashtohet çdo mundësi e ndotjes së qumështit dhe prodhimeve.

3. Për të gjitha proceset e punës është e detyrueshme të përdoret uji i pijshëm. Ndërsa për ftohjen e impianteve, për prodhimin e avullit ose për luftën kundër zjarrit mund të lejohet ujë jo i pijshëm, nëse tubacionet e vendosura për këtë qëllim nuk lejojnë një përdorim tjetër të këtij uji dhe përjashtojnë rrezikun e ndotjes së produkteve dhe lëndës së parë.

4. Lëndët dezinfektuese ose lëndë të ngjashme me to të autorizohen nga Inspektoriati Sanitar dhe të përdoren në atë mënyrë që të mos ndikojnë dhe/ose veprojnë negativisht mbi pajisjet, lëndët e para dhe produktet.

Ambalazhet e lëndëve dezinfektuese të identifikohen lehtë dhe të jenë të shoqëruara me një etiketë ku përshkruhet udhëzimi i përdorimit të tyre.

Në përfundim të dezinfektimit objektet e punës e pajisjet të shpëlahen shumë mirë me ujë të pijshëm.

B. Kushtet e përgjithshme higjienike për personelin

1. Nga personeli kërkohet pastërti maksimale. Kjo të zbatohet në mënyrë të veçantë nga persona që manipulojnë lëndët e para dhe produktet që përkufizohen sipas këtij ligji, të papaketuara, të ekspozuara ndaj ndotjes.

Veçanërisht:

personeli të përdorë veshje të përshtatshme e të pastra, flokët të mbahen komplet të mbuluar me një mbulesë të pastër;

personat që merren me trajtimin e lëndëve të para e produkteve që përkufizohen sipas këtij ligji, t'i lajnë duart të paktën para çdo rifillimi pune, si dhe në çdo rast ndotjeje;

plagosjet e lëkurës të mbulohen me një lidhëse të papërshkueshme nga uji;

ç) ndalohet pirja e duhanit, të pështyrit, të ngrënit e të pirit në repartet e punës dhe në atë të ruajtjes ose magazinimit të produkteve që përkufizohen sipas këtij ligji.

2. Punëdhënësi të kujdeset që personat, të cilët mund të infektjnë produktet e përkufizuara nga ky ligj, të përjashtohen për aq kohë nga puna, derisa të vërtetohet që këta persona nuk paraqesin rrezik për ndotjen e produkteve.

Të gjithë personat që trajtojnë produktet e përkufizuara nga ky ligj, të pajisen me certifikatë mjekësore, që të provojnë se nga ana mjekësore nuk kanë pengesa për të punuar në këtë sektor. Vrojtimi mjekësor i tyre bëhet sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.

KREU III KUSHTE TË VEÇANTA PËR PAJISJEN ME LEJE TË QENDRAVE TË GRUMBULLIMIT TË QUMËSHTIT

Përveç kushteve të përcaktuara në kreun I pika 2 shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe pika 4 shkronjat “b”, “c”, “d”, “dh”, “g” e “gj” të kësaj Shtojce, qendrat e grumbullimit të qumështit të disponojnë të paktën dhe:

a) mjete ose mënyra ftohëse të përshtatshme për ftohjen e qumështit dhe, kur qumështi depozitohet në qendrën e grumbullimit, pajisje depozituese me ftohje;

b) mjete ose mënyra filtruese të përshtatshme për pastrimin fizik të qumështit ose centrifugë, nëse ky proces parashikohet të kryhet në qendrën e grumbullimit.

KREU IV KUSHTE TË VEÇANTA PËR PAJISJEN ME LEJE TË QENDRAVE TË STANDARDIZIMIT

Përveç kushteve të përcaktuara në kreun I pika 2 shkronjat “a”, “b”, “ç”, “dh” dhe pika 4 shkronjat “b”, “c”, “d”, “dh”, “g” e “gj” të kësaj Shtojce, qendrat e grumbullimit të qumështit të disponojnë të paktën:

a) enë, cisterna për depozitimin në mjedis të ftohtë të qumështit të papërpunuar, pajisje për standardizimin dhe depozita (cisterna, tanke etj.) për depozitimin e qumështit të standardizuar;

b) centrifuga ose pajisje të tjera filtruese të përshtatshme për pastrimin fizik të qumështit.

KREU V KUSHTE TË VEÇANTA PËR PAJISJEN ME LEJE TË QENDRAVE PËRPUNUESE

Përveç kushteve të përgjithshme të parashikuara në kreun I, qendrat e përpunimit të plotë të disponojnë të paktën edhe:

a) një pajisje për mbushjen e mbylljen automatike të shisheve ose ambalazheve të tjera që përdoren për ambalazhimin e qumështit për konsum të trajtuar termikisht, si edhe bidonë e cisterna të taruara, kur ky operacion kryhet në fabrikë.

Në rastet e prodhimit në sasi të kufizuar të qumështit të destinuar për konsum, mund të lejohen dhe metoda ose mënyra të tjera alternative për mbushjen dhe mbylljen e ambalazheve për sa kohë ato garantojnë të njëjtën siguri nga pikëpamja e higjienës;

b) pajisje për ftohjen dhe depozitimin e ftohtë të qumështit të trajtuar termikisht të produkteve të lëngëta me bazë qumështi, si dhe në rastet e parashikuara në krerët III e IV të kësaj Shtojce, të qumështit të papërpunuar, kur këto procese kryhen në fabrikë. Cisternat e depozitimit duhet të jenë të pajisura me termometër për matjen ekzakte të temperaturës;

c) në rastin e ambalazhimit me ambalazh që përdoret vetëm një herë, një vend të përshtatshëm për mbajtjen e këtij ambalazhi.

Në rastin e ambalazhimit me ambalazh që ripërdoret, një vend të veçantë për depozitimin e këtij ambalazhi, si dhe pajisje për larjen e dezinfektimin mekanik të tij;

ç) depozita për depozitimin e qumështit të papërpunuar, pajisje për standardizimin, në rastin kur qumështi nuk kalon në qendrën e standardizimit, si dhe depozita për depozitimin e qumështit të standardizuar;

d) centrifuga ose pajisje të tjera filtruese të përshtatshme për pastrimin fizik të qumështit;

dh) një pajisje për trajtimin termik të qumështit, të miratuar e të autorizuar nga organet kompetente, e cila të jetë e pajisur me:

regjistruer automatik të temperaturës;

sistem automatik për shmangien e një ngrohjeje të pamjaftueshme;
sistem sigurie për mospërzierjen e qumështit të pastertilizuar ose të sterilizuar me qumështin që nuk është ngrohur në temperaturën e duhur;

- një pajisje regjistruese automatike për sistemin e sigurisë, përmendur në pikën më lart, ose një procedurë për monitorimin e efektivitetit të sistemit.

Kur miratohen qendra përpunimi, mund të lejohen pajisje të ndryshme që garantojnë të njëjtën punë e siguri nga pikëpamja higjienike;

e) pajisje për ftohjen, ambalazhimin dhe depozitimin e produkteve të ngrira me bazë qumështi, nëse këto operacione janë të nevojshme;

ë) pajisje për tharjen dhe ambalazhimin e produkteve në formë pluhuri me bazë qumështi, kur ato janë të nevojshme.

KREU VI

KRITERET HIGJIENIKE PËR LOKALET, MJETET E PUNËS DHE PERSONELIN NË QENDRAT E PËRPUNIMIT TË QUMËSHTIT

Përveç kushteve të përgjithshme të parashikuara në kreun II, qendrat e përpunimit të përmbushin edhe këto kushte:

1. Gjatë proceseve të punës të shmanget kontaminimi reciprok i shkaktuar nga pajisjet, nga ventilimi ose nga personeli. Nëse duhet, bëhet ndarja mbi bazën e shkallës së rrezikshmërisë. Repartet e prodhimit dhe të depozitimit ndahen në zona me lagështi e në zona të thata dhe secila nga këto zona vihet në kushte specifike funksionimi.

2. Pas çdo përdorimi ose në intervale shumë të shkurtra ndërmjet zbrazjes e mbushjes ose pas çdo serie përdorimi, enët e tanket e qumështit që janë përdorur për transportin e qumështit në qendrat e grumbullimit e standardizimit ose në fabrikat e përpunimit, të pastrohen dhe të dezinfektohen sa më shpejt që të jetë e mundur ose të paktën një herë në ditë, si dhe para se ato të përdoren përsëri.

3. Pajisjet, enët dhe linjat që bien në kontakt me qumështin, produktet me bazë qumështi ose lëndë të tjera që prishen gjatë prodhimit, të pastrohen dhe, nëse është e nevojshme, të dezinfektohen sipas një grafiku ose procedure që përputhet me parimet e një sistemi menaxhimi cilësie ose sistemi vetëkontrolli të implementuar nga drejtuesi i fabrikës.

4. Repartet e punës të pastrohen rrënjësisht të paktën një herë për çdo ndërresë pune.

5. Për pastrimin e pajisjeve të tjera, aparaturave, enëve etj., që bien në kontakt me produktet me bazë qumështi, mikrobiologjikisht të qëndrueshme, si dhe vendet ku produkte të tilla depozitohen, drejtuesi i qendrës paraqet një program pastrimi, që përputhet me parimet e një sistemi menaxhimi cilësie ose sistemi vetëkontrolli të implementuar nga ai.

KREU VII

PAKETIMI DHE AMBALAZHIMI

1. Paketimi dhe ambalazhimi të plotësojnë të gjitha rregullat higjienike dhe të jenë mjaft të qëndrueshëm (të fortë) për të garantuar një mbrojtje efektive të produkteve që mbulohen nga ky ligj.

2. Procesi i mbushjes së qumështit të trajtuar termikisht dhe produkteve të lëngshme të qumështit, si dhe procesi i mbylljes së ambalazhit e paketimit të kryhen në mënyrë automatike.

Në raste të prodhimit në sasi të paktë, mund të lejohet përdorimi i metodave të tjera të mbylljes, me kusht që këto të kenë të njëjtën siguri nga pikëpamja higjienike.

3. Veshjet ose ambalazhet e produkteve që trajtohen nga ky ligj nuk duhet të ripërdoren. Nëse bëhet fjalë për ripërdorim të ambalazheve ose të veshjeve, ato të pastrohen dhe të dezinfektohen tërësisht. Mbyllja hermetike e ambalazheve të kryhet menjëherë pas mbushjes në fabrikën ku qumështi trajtohet termikisht për herë të fundit, me anë të një pajisjeje mbyllëse që garanton mbrojtjen e produktit nga ndikimet negative të jashtme. Sistemi i mbylljes duhet të jetë i tillë që të mund të njihet dhe të kontrollohet lehtë ndonjë çarje ose hapje e tij.

4. Krahas kushteve të parashikuara në kreun IX, drejtuesi i qendrës së përpunimit të marrë masa që mbi ambalazhin e qumështit të trajtuar termikisht ose produkteve të qumështit, për qëllime kontrolli, të vendosen në mënyrë të dukshme dhe të lexueshme qartë:

natyra e trajtimit termik, të cilit i është nënshtruar qumështi i papërpunuar;

një shënim me anë të një kodi ose jo, ku të shënohet data e prodhimit;
për qumështin e pasterizuar temperatura e ruajtjes së produktit.

5. Lejohet që qumështi dhe produktet të pakëtohen e të ambalazhohen në të njëjtin lokal ku prodhohen, vetëm nëse paketimi e ambalazhimi i përgjigjen vetive të përmendura në pikën 1 dhe që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) lokali të jetë ndërtuar në atë mënyrë që të sigurohet një punë higjienike e proceseve;
- b) materialet e ambalazhimit që sillen në qendrën përpunuese, magazinohen higjienikisht në një dhomë të parashikuar për këtë qëllim. Këto materiale të jenë të mbështjella me veshje mbrojtëse menjëherë pas prodhimit të tyre, e cila i mbron ato nga dëmtimet gjatë transportit;
- c) dhomat e depozitimit të materialeve të paketimit e ambalazhimit të jenë të mbrojtura nga pluhuri dhe parazitët dhe të jenë, gjithashtu, të ndara nga dhomat ku gjenden lëndë që mund të ndotin qumështin ose produktet. Këto materiale nuk lejohet të vendosen direkt në dyshe;
- ç) përgatitja e ambalazheve kryhet duke respektuar rregullat higjienike para dërgimit në fabrikë. Mund të tolerohet nga ky kusht nëse ambalazhi konfeksionohet (vishet) automatikisht dhe nëse përjashtohet çdo rrezik i kontaminimit të produkteve;
- d) ambalazhet dërgohen në lokalet e ambalazhimit, duke respektuar rregullat e higjienës dhe të përdoren menjëherë pasi hyjnë në to. Ato nuk duhet të përdoren nga punëtorë që janë caktuar në punë me produkte të paambalazuara;
- dh) produktet, menjëherë pas ambalazhimit, dërgohen në dhomën e parashikuar për depozitimin e tyre.

KREU VIII RREGULLA PËR VENDOSJEN E VULËS SË PRODHUESIT

Vula vendoset mbi vetë produktin, mbi veshjen e tij ose në etiketën që vendoset mbi ambalazhin e tij. Kur produkte të vogla pakëtohen veç e veç dhe pastaj ambalazhohen së bashku, ose kur produkte të tilla të vogla të pakëtuara në porcione të veçanta kalojnë direkt te konsumatori, vula e prodhuesit të vihet në ambalazhin e përbashkët.

Kur produkteve parashikohet t'u vihet vula, në përputhje me pikën 1 dhe më pas ambalazhohen, vula e prodhuesit duhet të vendoset dhe mbi këtë ambalazh.

- a) Vula e prodhuesit duhet të përmbajë në një fushë ovale të dhënat e mëposhtme:
 - a1) në pjesën e sipërme, me shkronja të mëdha, simbolet AL;
 - a2) në mes, me shkronja të mëdha, numrin e licencës së fabrikës;
 - a3) në pjesën e poshtme emrin e firmës prodhuese dhe qytetin.
- b) Vula e prodhuesit mund të vendoset me stampë me bojë ose me të djegur mbi produkt, mbi veshjen, mbi ambalazhin ose mbi etiketë.
- c) Vula e prodhuesit mund të bëhet edhe me një tabelë prej metali rezistent dhe të vendoset në mënyrë të tillë që mund të lëvizet e të hiqet dhe që i përmbush të gjitha normat higjienike. Ajo duhet të përmbajë të gjitha përshkrimet e dhëna në shkronjën "a" të këtij kreu.

KREU IX RREGULLAT PËR RESPEKTIMIN E ETIKETIMIT

Për qëllime kontrolli, duhet që në etiketën e qumështit dhe të produkteve me bazë qumështi, në të cilat mund të verifikohet një zhvillim mikrobik, të shënohet në mënyrë të qartë:
data brenda së cilës duhet përdorur ose jetëgjatësia në treg.

KREU X KËRKESA PËR MAGAZINIMIN DHE TRANSPORTIN

Qumështi dhe produktet e tij që nuk mund të magazinohen në temperaturën e dhomës, për shkak të paqëndrueshmërisë së tyre në këto kushte, të magazinohen në atë temperaturë që këshillon prodhuesi për garantimin e qëndrueshmërisë së tyre. Në mënyrë të veçantë për qumështin e pasterizuar

lejohe temperaturë, deri në dalje nga fabrika dhe gjatë transportit, jo më e lartë se +6 gradë C. Në magazinimin në të ftohtë, temperatura duhet të jetë e regjistrueshme dhe të sigurohet rendimenti i ftohjes, në mënyrë që temperatura e kërkuar e produktit të arrihet në një kohë sa më të shpejtë.

Cisternat, bidonët dhe enët e tjera të transportit të qumështit duhet të plotësojnë të gjitha normat e higjienës, në veçanti duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

Muret e brendshme të tyre dhe pjesët e tjera që mund të bien në kontakt me qumështin duhet të prodhohen nga një material i lëmuar dhe i qëndrueshëm ndaj korrozionit, i lehtë për t'u larë, pastruar dhe dezinfektuar, si dhe të mos lëshojnë në qumësht lëndë të dëmshme në sasi të tilla që të rrezikojnë shëndetin e konsumatorëve, si dhe lëndë që mund të ndryshojnë përbërjen e qumështit ose të influencojnë negativisht në vetitë organo-shqisore të tij.

Të konstruktohen në atë mënyrë që qumështi të zbrazet tërësisht, pa mbetje: nëse enët janë pajisur me rubineta, atëherë ato duhet të jenë lehtësisht të zmontueshme, për t'u larë, pastruar e dezinfektuar lehtësisht.

Menjëherë pas çdo përdorimi të lahen, të pastrohen e të dezinfektohen dhe, nëse është e nevojshme, edhe para çdo përdorimi. Pastrimi e dezinfektimi të kryhen sipas kreut VI pikat 2 dhe 3.

Ato duhet të mbyllen hermetikisht para dhe gjatë transportit me anë të një kapaku të papërshkueshëm nga uji.

Automjetet dhe enët mbajtëse për transportin e produkteve të dëmtueshme lehtë, që trajtohen në këtë ligj, duhet të jenë konstruktuar e pajisur në mënyrë të tillë që temperatura e paracaktuar të ruhet gjatë gjithë kohëzgjatjes së transportit.

Automjetet që përdoren për transportin e qumështit të trajtuar me ngrohje dhe të qumështit të ambalazhuar në ambalazhe të vogla ose në bidonë të jenë në gjendje të mirë. Ato nuk duhet të përdoren për transportin e çfarëdolloj produkti tjetër që mund të sjellin prishjen e qumështit. Sipërfaqet e brendshme të tyre të jenë të lëmuara, si dhe të lehta për t'u larë, pastruar e dezinfektuar. Pjesa e brendshme e automjetit të plotësojë të gjitha normat higjienike. Automjetet për transportimin e qumështit të trajtuar me ngrohje dhe të ambalazhuar në ambalazhe të vogla të jenë të konstruktura në mënyrë që t'i mbrojnë ato nga çdo lloj kontaminimi dhe influence atmosferike. Ato nuk mund të përdoren për transportin e kafshëve.

Për këtë qëllim, Inspektoriati i Kontrollit të Ushqimit të kontrollojë rregullisht nëse mjetet e transportit dhe kushtet e shkarkimit u përgjigjen kriterëve higjienike të këtij kreu.

Produktet e trajtuara nga ky ligj të transportohen në mënyrë të tillë që, sipas kohëzgjatjes, kushteve të transportit dhe mjeteve të parashikuara për këtë, të jenë të mbrojtura nga çdo burim kontaminimi ose ndikimi negativ.

Gjatë transportit të qumështit të pasterizuar në cisterna, ambalazhe të vogla dhe bidonë, temperatura e qumështit nuk duhet t'i kalojë +6 gradë C. Gjatë shpërndarjes në pikat e shpërndarjes me pakicë ose në rastet e shitjes me abonim familjar, mund të lejohet një tolerancë prej dy gradësh nga kriteri i mësipërm.

Këshilli i Ekspertëve të Qumështit dhe produkteve të qumështit mund të përcaktojë kushte shtesë për magazinimin dhe transportin e disa produkteve specifike me bazë qumështi.

Fletorja Zyrtare gjendet: duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën: Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468
Për më tepër informacion vizitoni faqen e internetit:
www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR
NGA MINISTRIA E DREJTËSISË 2005**

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1500
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	1200
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	1000
4. INDEKSI ALFABETIK	1000

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë, Vëllim i II-të, Botim 2005)....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 8.12.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë